ISSUE 95 / MAY 2019

# The AmCham Advantage

THE **OFFICIAL MAGAZINE** OF THE AMERICAN CHAMBER OF COMMERCE IN ALBANIA

WWW.AMCHAM.COM.AL



## AmCham Elects New Leadership

AMCHAM ORGANIZES BUSINESS FORUM ON **EMPLOYMENT AND PROFESSIONAL DEVELOPMENT**

STANDING TOGETHER FOR **IP RIGHTS**

**HUMAN RESOURCES TRAINING**

# AMCHAM BOARD



**PRESIDENT**
Enio JAÇO
*CBS Creative Business Solutions*



**VICE-PRESIDENT**
*Radmilo VLACIC*
*Philip Morris Albania*



**SECRETARY**
*Reshard KËLLIÇI*
*The Harry T. Fultz Institute*



**TREASURER**
*Juela ISAJ*
*DDB Albania*

## BOARD MEMBERS



*Jeffrey BARRETT*
*LinkAcross*



*Eni XHEKO SERBO*
*Xheko Imperial Hotel*



*Dael DERVISHI*
*Optima Legal & Financial*




## CONTENTS / PËRMBAJTJA

PUBLISHER:
American Chamber of Commerce in Albania

EDITOR IN CHIEF:
Brikena Kamenica

DESIGN & LAYOUT:
Eduard Bujari

PRINTED BY:
Gent Grafik

The content of this publication cannot be reproduced in full or part without the prior written permission of the publisher.

© COPYRIGHT FEBRUARY, 2019

Rruga "Ibrahim Rrugova", Sky Tower, Suita 11-3 Tirana, Albania

PHONE:
+355 4 225 9779

E-MAIL:
info@amcham.com.al

WEB:
www.amcham.com.al

NR. 95 / MAJ 2019
ISSUE 95 / MAY 2019

The AmCham Advantage




**8**

**ELECTIONS AT AMCHAM**
The General Assembly Meeting 2019 elected the President, Secretary and two Board Members

**ZGJEDHJET NË AMCHAM**
Asambleja zgjedh Presidentin, Sekretarin dhe dy anëtarë Bordi

**14**

AMCHAM EXPLORES BUSINESS ETHICS
AMCHAM FLET PËR ETIKËN NË BIZNES

**18**

CEO Forum hosts Finance and Economy Minister Anila Denaj

Forumi i CEO-ve mirëpret Ministren e Financave dhe të Ekonomisë, znj. Anila Denaj



**44**

Albanian CEO Survey, as part of PwC's 22nd Annual Global CEO Survey – PricewaterhouseCoopers Albania

Anketimi i CEO-ve në Shqipëri, si pjesë e Anketimit Global Vjetor të 22-të PwC - PricewaterhouseCoopers Albania

**22**

AMCHAM ORGANIZES BUSINESS FORUM ON EMPLOYMENT AND PROFESSIONAL DEVELOPMENT

DHOMA AMERIKANE, FORUM BIZNESI PËR PUNËSIMIN DHE ZHVILLIMIN PROFESIONAL





**34**

Labor and Ethics Committee brings in u.s. specialist to discuss HR department issues

Komiteti i punës dhe i etikës flet për zhvillimet në departamentin e HR-it me specialisten amerikane



**38**

AmCham Board meets with representatives of Democratic Party

Dhoma Amerikane takohet me përfaqësues të Partisë Demokratike

**20** AmCham holds Working Breakfast with Minister Shalsi
Dhoma Amerikane, Mëngjes Pune me Ministrin Shalsi

**26** Business Forum with the State Market Monitoring Inspectorate
Forumi i Biznesit me Inspektoriatin Shtetëror për Mbikëqyrjen e Tregut

**42** MEMBER NEWS
LAJME ANETARESH

**48** FORMALIZING the economy through cashless bank transactions
Formalizimi i ekonomisë përmes pagesave nëpërmjet bankës

**30** AmCham Albania speaks with stakeholders on the protection of Intellectual Property Rights
Dhoma Amerikane flet me aktorët kryesore të mbrojtjes së Pronësisë Intelektuale

**36** Human Resources Training for the development of HR functions ranging from Staff to Strategic Business Advisor
Zhvillimi i funksioneve të Burimeve Njerëzore nga "Personeli" në "Këshilltar Strategjik të Biznesit"

**40** Optima Foundation and AmCham together for a clean coast
Fondacioni Optima dhe Dhoma Amerikane bashkë për një bregdet të pastër

## PATRON MEMBERS

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| INTESA SANPAOLO BANK Albania | Coca-Cola TASTE THE FEELING CCBS | WESTERN UNION | DHL | CCS Computer & Copier Systems |
| TCN | 3N1 | M&D Marketing & Distribution ALBANIA | GSA AUTOMATION SYSTEMS GROUP | SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP |
| kesh Clean energy that never depletes! Albanian Power Corporation | Kika Construction | fufarma since 1946 | AK INVEST INSTITUCION FINANCIAR | PVN HOTEL COLOSSEO SHKODER - TIRANE |
| KRUJACEM FUSHË KRUJË CEMENT FACTORY | Bankers PETROLEUM ALBANIA LTD. 洲际油气 A Geo-Jade Company | InfoSoft Systems ...better together... | INTERSIG VIENNA INSURANCE GROUP | D20 Devi 20 grup |
| BALFIN BALKAN FINANCE INVESTMENT GROUP | EY Building a better working world | eida | ProCredit Bank Albania | THG TOBACCO HOLDING GROUP |
| ALPHA BANK | dimapak make it easy | EHW GmbH | Teuta DURRËS | Statkraft |
| Tendence 3A | BAKER HUGHES a GE company | S2 GLOBAL An OSI Systems Company | AlbStar | aed one vision. |
| GUARDIAN GLASS See what's possible™ | DELIA GROUP CONSTRUCTION | PRIMALL | Hilton Garden Inn Tirana | CREDINS bank Ne fjalim gjuhën tuaj! |
| | | | | |
| | | | | |

# A Message from our President

Dear Members,

Thank you for your trust and support on electing me as your President. I'm both excited and humble to serve in this role and I will do my best to earn your support.

I had an opportunity to meet with many of you before and during the General Assembly. AmCham is an impressive organization, with small and large businesses, regional market leaders from a multitude of industry sectors. Not only we represent a powerful network of 192 members with a combined $5 Billion in annual revenue, but we are also one of the strongest institutions in Albania.

To further strengthen our operations, we adopted new changes related to our board and membership structure last year-in par with our AmCham sister organizations across Europe and our region.

But the biggest changes are yet to come. I'm excited to work with a new and dynamic Board of Directors, to implement a new vision for AmCham focused on:

- Strengthening our organization by delivering greater value to you. Powerful and more effective committees, better and diversified activities, more well-organized advocacy efforts and higher value networking opportunities for our members.
- Bigger Investment opportunities for both foreign and domestic investments in Albania, enabling connections for our members with trade partners in Europe and US, adding great value to business portfolios.
- A better business-enabling environment for you to operate on, by advocating strong and meaningful industry reforms that are rule-based, transparent and market-oriented.

To achieve impact, we need your support and engagement. Please stay active with our committees, join our activities, check our social media pages and rally around advocacy efforts. Together we can make it!

*Thank you again for your amazing support!*
*I look forward to working with you in the next two years!*

**Enio Jaco**
*President*

# Mesazh nga Presidenti



Të nderuar Anëtarë,

Ju falenderoj për besimin dhe mbështjetjen në votimin e Asamblesë. Ndihem njëkohësisht i emocionuar dhe i nderuar për rolin dhe do të jap më të mirën për të fituar besimin tuaj.

Kohët e fundit kam patur mundësinë të takohem me shumë prej jush. AmCham është një organizatë mbresëlënëse, me një përfaqësi biznesesh të mëdha e të vogla nga sektorë të ndryshëm, lider në tregun rajonal. AmCham përfaqëson jo vetëm një rrjet të fuqishëm me 193 anëtarë dhe një total prej $5 Mld të ardhura vjetore, por gjithashtu është një nga institucionet më të forta në Shqipëri.

Për të forcuar më tej aktivitetet dhe organizimin e Dhomës, vitin e kaluar u adaptuan ndryshime specifike në strukturën e Bordit Drejtues dhe u reformuan kategoritë e anëtarësisë – në një hap me organizatat tona si-motra në Evropë dhe në rajon.

Por ndryshime më të mëdha kemi përpara. Unë jam entuziast të punoj me një Bord Drejtues me një frymë të re dhe dinamike, për implementimin e një vizioni të ri për AmCham të fokusuar në:

- Forcimin e organizatës në një mënyrë që t'ju ofrojë ju më shumë vlerë. Komitete të fuqishme dhe më efikase, aktivitete të larmishme, aktivitete më efikase lobuese dhe mundësi më të vlefshme network-u për anëtarët tanë.
- Mundësi më të mëdha investimesh të huaja dhe vendase në Shqipëri, duke krijuar marrëdhënie për anëtarët tanë me partnerët tregtarë në Evropë dhe SHBA, duke rritur vlerën e portofoleve të bizneseve anëtare.
- Një mjedis më të favorshëm biznesi, duke mbështetur reforma të rëndësishme të industrisë, të bazuara në rregulla, transparencë dhe të orientuara nga tregu.

Për të patur impaktin e duhur, ne kemi nevojë për mbështetjen dhe angazhimin tuaj. Ju ftoj të qëndroni aktivë me komitetet tona, të bëheni pjesë e aktiviteteve, të na ndiqni në mediat tona sociale dhe të bashkojmë përpjekjet tona lobuese. Së bashku mund t'ia arrijmë!

*Ju faleminderit edhe një herë për mbështetjen!*
*Pres me entuziazëm të punojmë së bashku në dy vitet e ardhshme!*

**Enio Jaço,**
*President*




# Elections at AmCham

## The General Assembly Meeting 2019 elected the President, Secretary and two Board Members





The American Chamber of Commerce organized the General Assembly Meeting who served to elect the new President, Secretary and two Board Members. With the majority of votes, at the end of the election process, the members of AmCham elected as President, Mr. Enio Jaço, CEO of CBS, as Secretary, Mr. Reshard Këlliçi, representative of Harry T. Fultz Institute, and as members, Mr. Jeffrey Barrett, from Link Across and Ms. Eni Xheko, CEO of Xheko Imperial Hotel.

The General Assembly Meeting serves as the moment to make the balance of the work that AmCham has done over the last year and to introduce the Business Index. The President, Mark Crawford, in his last speech before leaving this position at AmCham, made an expose of the financial situation of the organization, of the new membership categories format, of the members and of the work done by the Board to apply reforms that has brought changes at AmCham.

Focusing on the results of the Business Index 2018 – 2019, Mr. Crawford informed that the Index has increased with 0.71 points compared with the Index of 2018, reaching by now 43.16 points. Unlike last year, when taxes were the main concern of businesses, this indicator has marked improvement with 6.4 points, positioning it as the fourth problem in the list. In 2018, members were concerned about the monopoly and the unfair competition, with a nearly, 4 points deterioration. The second biggest concern of business members is finding qualified local staff, this also has had a slight deterioration.

> “Focusing on the results of the Business Index 2018 – 2019, Mr. Crawford informed that the Index has increased with **0.71 points compared with the Index of 2018, reaching by now 43.16 points.**

The Deputy Chief of Mission in charge of US Embassy in Tirana, Mr. Daniel Koski, in his remarks emphasized the fact that the justice reform will solve a lot of problems that businesses have faced and will be a crucial factor in helping to create a good business climate, not only for Albanian companies but also for foreign and US investors.

“A reformed judicial system will guarantee the inviolability of the contract. The foreign and local investors ask that contracts should be respected and enforced. Investors should be ensured that that they will be compensated for the sale of their products and services under the terms agreed by each party” – said Mr. Koski during the meeting.

All the candidates introduced their selves and their platforms that will help them to contribute at the Board of Am-




# Zgjedhjet në AmCham

## Asambleja zgjedh Presidentin, Sekretarin dhe dy anëtarë Bordi

Dhoma Amerikane ka organizuar Mbledhjen e Përgjithshme të Asamblesë, e cila ka shërbyer për të zgjedhur Presidentin e ri, Sekretarin dhe dy anëtarë Bordi. Me shumicë votash në fund të procesit të zgjedhjeve, anëtarët e Dhomës i deleguan përgjegjësinë e Presidentit, z. Enio Jaço, nga CBS Creative Business Solutions, z. Reshard Këlliçi nga Instituti Harry T. Fultz në rolin e Sekretarit dhe zgjodhën dy anëtarë të rinj të Bordit, z. Jeffrey Barrett nga LinkAcross dhe znj. Eni Xheko nga Xheko Imperial Hotel. Mbledhja e Përgjithshme e Asamblesë shërben edhe si një moment i bilancit të punës që ka bërë Dhoma gjatë një viti dhe i prezantimit të Indeksit të Biznesit (ABI). Presidenti Mark Crawford në prezantimin e tij të fundit përpara se të ndërronte presidencën e AmCham-it, bëri një ekspoze të gjendjes financiare, formatimit të ri të kategorive të anëtarëve dhe të punës që ka bërë Bordi për të aplikuar reforma që sjellin ndryshime në Dhomën Amerikane.

Duke folur për rezultatet e Indeksit e Biznesit 2018 - 2019, z. Crawford informoi se Indeksi në 2018-ën u rrit me 0.71 pikë në krahasim me vitin e mëparshëm, duke arritur në 43.16 pikë. Ndryshe nga viti i kaluar, kur taksat ishin shqetësimi kryesor i biznesit, ky tregues ka shënuar përmirësim me 6.4 pikë, duke kaluar në problemin e katërt. Për 2018-ën, shqetësimi kryesor i anëtarëve të Dhomës Amerikane ishte monopoli dhe konkurrenca e pandershme, me një përkeqësim prej gati 4 pikësh. Shqetësimi i dytë ishte gjetja e stafit lokal të kualifikuar dhe ky me një përkeqësim të lehtë. Zëvendësambasadori në Detyrë i SHBA-ve në Tiranë, z. Dan Koski, gjatë fjalës së tij në Asamblenë e Përgjithshme theksoi faktin se reforma në drejtësi do t'i japë zgjidhje shumë problematikave që ka hasur biznesi dhe do të ndihmojë për të krijuar një klimë më të mirë jo vetëm për kompanitë vendase, por edhe për biznesin e huaj dhe atë amerikan.

> Duke folur për rezultatet e Indeksit e Biznesit 2018 - 2019, z. Crawford informoi se Indeksi në 2018-ën u rrit me **0.71 pikë në krahasim me vitin e mëparshëm, duke arritur në 43.16 pikë.**

"Një sistem gjyqësor i reformuar do të zbatojë paprekshmërinë e kontratës. Investitorët e huaj dhe vendas kërkojnë sigurinë që kontratat do të respektohen dhe zbatohen. Investitorët duhet të kenë besim se ata do të kompensohen për shitjen e produkteve dhe shërbimeve të tyre sipas kushteve të miratuara nga secila palë" - u shpreh z. Koski gjatë takimit. Gjatë mbledhjes, të gjithë kandidatët prezantuan platformat e tyre me të cilat ata mendojnë se do të kontribuojnë në Bordin e Dhomës Amerikane. Duke folur për idetë dhe mbi mënyrën se si do ta zhvillojë Dhomën Amerikane, Presidenti i ri z. Enio Jaço u shpreh se: "Jam krenar për Dhomën Amerikane, e cila është dhoma më efektive e biznesit në




Cham. Talking about his idea on the way he would develop AmCham, the new President, Mr. Enio Jaço said that "I'm proud of AmCham, which is the most effective business chamber in Albania today. It functions as a real institution with proper rules and procedures in place that would be the envy of many institutions. AmCham is also a significant force –a union of 200 more businesses with a combined annual revenue of $5 Billion. AmCham is also a global network of 115 branches in more than 100 countries. I see my mission at working hard to making AmCham more effective and more influential by creating more markets for its members and building a more friendly business environment in Albania".

## REMARKS BY A/ DCM KOSKI AT THE AMERICAN CHAMBER OF COMMERCE GENERAL ASSEMBLY

### How will judicial reform improve Albania's business climate? **Allow me to give you six examples.**

**FIRST,** an ethical and honest judiciary will make sure corrupt prosecutors and judges are finally held accountable. The days of dirty deals and justice denied are coming to an end. A criminal justice system that is tough on corruption and organized crime will provide confidence to legitimate businesses that their interests will be protected.

**SECOND**, a reformed judicial system will enforce contract sanctity. Foreign and domestic investors require certainty that contracts will be honored and enforced. Investors must have confidence that they will be compensated for the sale of their products and services according to the terms agreed to by each party.

**THIRD,** a fair and independent legal system will encourage businesses to seek official registration, and deter disreputable actors from paying bribes to avoid their tax obligations. Reputable investors strive to remain in compliance with the law and pay their taxes. Yet business owners have complained that many of their foreign and domestic competitors—including the many companies that operate informally in Albania—do not pay taxes. A reformed judiciary will help level the playing field for every reputable business operating in Albania.

**FOURTH,** a fair and independent judiciary will ensure protection of real property rights. Investors cite the chaos surrounding property claims as an example of how the legal system has deterred long-term economic growth in Albania. In one typical case, a family was restituted a parcel of property, but was unable to finalize possession for more than 20 years. Other claimants emerged later and, behind closed doors, persuaded judges that they should be awarded the land. This back door practice of stealing other people's property will soon stop.

> **...a fair and independent legal system will encourage businesses to seek official registration,** and deter disreputable actors from paying bribes to avoid their tax obligations.

**FIFTH,** a professional legal system will ensure protection of IP rights. Ideas and knowledge are a vital part of trade and investment, and investors require confidence that their intellectual property rights will be respected and violators will be brought to justice.

**FINALLY,** an honest and functioning legal system will ensure that corrupt officials will either think twice – or pay the price – for soliciting a bribe. Corruption at ports and border control points is one of the most problematic factors for investors and international trade, and a problem that was cited in this year's AmCham Business Index. If corrupt customs officials won't do their jobs, a reformed legal system will remove them to make room for reputable people who will. The United States is confident that judicial reform in Albania will create a fair, transparent, and predictable business climate that is better for your businesses and for all American companies inspired to invest here.



**JEFFREY BARRETT** / MEMBER



**ENI XHEKO SERBO** / MEMBER



**RESHARD KËLLIÇI** / SECRETARY

Shqipëri sot. Ajo funksionon si një institucion i vërtetë me rregullat dhe procedurat e duhura që do të kishin zili shumë institucione. AmCham është gjithashtu një forcë e rëndësishme - një bashkim prej 200 biznesesh e më shumë me një të ardhur vjetore të kombinuar prej $ 5 miliard. AmCham është gjithashtu një rrjet global prej 115 degësh në më shumë se 100 vende. Unë e shoh misionin tim për të punuar shumë për ta bërë Dhomën Amerikane më efektive dhe më me ndikim duke krijuar më shumë tregje për anëtarët e saj dhe duke ndërtuar një ambient më miqësor të biznesit në Shqipëri ".

## FJALA E ZV. AMBASADORIT NË DETYRË **Z. DAN KOSKI**

### Si do ta përmirësojë reforma në drejtësi klimën e biznesit të Shqipërisë? **Më lejoni t'ju jap gjashtë shembuj.**

**SË PARI,** një gjyqësor etik dhe i ndershëm do të sigurojë që prokurorët dhe gjyqtarët e korruptuar më në fund të mbahen përgjegjës. Ditëve të marrëveshjeve të pista dhe drejtësisë së mohuar po u vjen fundi. Një sistem i drejtësisë penale që është i ashpër me korrupsionin dhe krimin e organizuar do të sigurojë tek bizneset e ligjshme besimin që interesat e tyre do të mbrohen.

**SË DYTI,** një sistem gjyqësor i reformuar do të zbatojë parekshmërinë e kontratës. Investitorët e huaj dhe vendas kërkojnë sigurinë që kontratat do të respektohen dhe zbatohen. Investitorët duhet të kenë besim se ata do të kompensohen për shitjen e produkteve dhe shërbimeve të tyre sipas kushteve të miratuara nga secila palë.

**SË TRETI,** një sistem ligjor i drejtë dhe i pavarur do t'i nxisë bizneset të kërkojnë regjistrim zyrtar dhe do të pengojë aktorët e pandershëm të paguajnë ryshfet për të shmangur detyrimet e tyre tatimore. Investitorët e respektuar përpiqen të qëndrojnë në përputhje me ligjin dhe të paguajnë taksat e tyre. Megjithatë, pronarët e bizneseve janë ankuar se shumë nga konkurrentët e tyre të huaj dhe vendas, përfshirë shumë kompani që veprojnë jozyrtarisht në Shqipëri, nuk paguajnë taksa. Një gjyqësor i reformuar do të ndihmojë në balancimin e hapësirës për çdo biznes me reputacion që vepron në Shqipëri.

**SË KATËRTI,** një gjyqësor i drejtë dhe i pavarur do të sigurojë mbrojtjen e të drejtave të pronës së patundshme. Investitorët përmendin kaosin rreth pretendimeve pronësore si një shembull se si sistemi ligjor ka penguar rritjen ekonomike afatgjatë në Shqipëri. Në një rast tipik, një familjeje iu kthye një parcelë prone, por nuk ishte në gjendje ta merrte përfundimisht pronësinë për më shumë se 20 vjet. Më vonë dolën pretendues të tjerë, dhe, pas dyerve të mbyllura, ata i bindën gjyqtarët se toka duhej t'iu jepej atyre. Kjo praktikë nën rrogoz e vjedhjes së pronës së njerëzve të tjerë do të ndalet së shpejti.

> ...**një sistem ligjor i drejtë dhe i pavarur do t'i nxisë bizneset të kërkojnë regjistrim zyrtar** dhe do të pengojë aktorët e pandershëm të paguajnë ryshfet për të shmangur detyrimet e tyre tatimore.

**SË PESTI,** një sistem ligjor profesional do të sigurojë mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale. Idetë dhe njohuritë janë një pjesë jetike e tregtisë dhe investimeve dhe investitorët kërkojnë besim që të drejtat e tyre të pronësisë intelektuale respektohen dhe shkelësit do të nxirren para drejtësisë.

**SË FUNDI,** një sistem ligjor i ndershëm dhe funksional do të sigurojë që zyrtarët e korruptuar ose do ta mendojnë dy herë, ose do të paguajnë çmimin për kërkimin e ryshfetit. Korrupsioni në portet dhe pikat e kontrollit kufitar është një nga faktorët më problematikë për investitorët dhe tregtinë ndërkombëtare, si dhe një problem që u përmend në Indeksin e Biznesit të Dhomës Amerikane të këtij viti. Nëse zyrtarët e korruptuar të doganave nuk do të bëjnë punën e tyre, një sistem ligjor i reformuar do t'i largojë për të krijuar hapësirë për njerëz me reputacion që do të bëjnë punën. Shtetet e Bashkuara kanë besim se reforma në drejtësi do të krijojë një klimë biznesi të drejtë, transparente dhe të parashikueshme, e cila është më e mirë për bizneset tuaja dhe për të gjitha kompanitë amerikane të frymëzuara për të investuar në Shqipëri.


Gold Sponsors
CREDINS bank
S2 GLOBAL
ALPHA BANK














ALPHA BANK




20 YEARS












CEOs FORUM
Mark Crawford
TRADE & INVESTMENT COMMITTEE
TAX & CUSTOMS COMMITTEE
REGULATORY, LEGAL & IPR COMMITTEE
LABOR & ETHICS COMMITTEE
COMMITTEES




General
World Vision
20 YEARS
Coffee Club
Mr. Enio Jaçe


Platinum Sponsor
abi
Gold Sponsors
CREDINS bank
Silver Sponsors

AMCHAM EXPLORES

# BUSINESS ETHICS

## Conference brings together government and businesses to a discussion promoting ethics in working relationships

> The conference marked a first step to building a solid business relationship that supports **development but also a market competition that is based on ethical principles.**



AmCham Albania organized its first Ethics in Business Conference, which brought together senior representatives from the United States and Albania. Conference Moderator Roden Pajaj, who also serves as head of the AmCham Labor and Ethics Committee, led discussions between the speakers and the audience on how business can best implement the Code of Ethics to improve how companies are run and re-shape how business is done. Exploring the conference's purpose, Mr. Pajaj stressed that the topic was chosen with care and the committee he leads has made it a priority for the American Chamber of Commerce in Albania to address business ethics. The conference marked a first step to building a solid business relationship that supports development but also a market competition that is based on ethical principles.



Former AmCham President Mark Crawford noted in his remarks that there are cultural differences between Albania and the United States and the conference would help bring the good experience of U.S. companies to Albania.

In his remarks at the conference, Nathan Estruth, Vice President of Global USA Ltd., spoke about the role of business ethics and how leaders should apply ethics in their relations with staff, partners and clients. Through his experiences, Mr. Estruth explained how to best further explore the topic of business ethics and that such trainings can help both employees and companies grow. "These beliefs affect who we are and what we want to become and help your business grow," he said at the conference.



Explaining the moral and ethical evolution that affects the individual but also impacts the entire society -- and as a result all businesses – Mr. Estruth said that the way leaders set their leg-

AMCHAM FLET PËR

# ETIKËN në BIZNES

## Konferenca ul qeverinë dhe biznesin në një diskutim që promovon etikën në marrëdhëniet e punës




AmCham Albania organizoi konferencën e parë “Etika në Biznes”, me prezencën e personaliteteve të lartë nga SHBA-ja dhe Shqipëria. Moderatori i konferencës dhe njëkohësisht Kryetari i Komitetit të Punës dhe Etikës, z. Roden Pajaj, ndërveproi me folësit kryesorë dhe audiencën dhe i përfshiu ata në diskutimet lidhur me zbatimin e Kodit të Etikës në bizneset e tyre, me qëllim përmirësimin e të bërit biznes. Z. Pajaj duke folur për qëllimin e konferencës, theksoi se tema nuk është e rastësishme dhe seKomiteti i Punës dhe Etikës e ka në fokusin e vet që parimet e etikës t’i bëjë një normë pune tek bizneset e Dhomës Amerikane. Konferenca është hapi i parë për të ndërtuar një marrëdhënie solide biznesi që mbështet zhvillimin, por dhe konkurrencën në treg mbi parimet e etikës.

Ish Presidenti i Dhomës Amerikane, z. Mark Crawford, në fjalën e tij deklaroi se ka një kulturë të ndryshme midis Amerikës dhe Shqipërisë dhe kjo konferencë do të ndihmojë për të sjellë një eksperiencë të mirë të kompanive amerikane në Shqipëri. Gjatë konferencës, z. Nathan Estruth, Zëvendëskryetari i SHPK-së Global USA foli për rolin e etikës në biznes dhe se si liderët duhet të zbatojnë etikën në marrëdhëniet e tyre me stafin, partnerët dhe klientët. Z. Estruth nëpërmjet eksperiencës së tij, ka shpjeguar se si punonjësit zhvillojnë vetveten dhe këtë formim e vendosin në zhvillimin edhe të kompanisë. “Janë bindjet ato që ndikojnë në çfarë jemi dhe çfarë duam të bëhemi, dhe kjo ndihmon për të zhvilluar edhe biznesin tuaj “ – u shpreh gjatë takimit z. Estruth. Duke shpjeguar për evolucionin

> Konferenca është hapi i parë për të ndërtuar një marrëdhënie solide biznesi **që mbështet zhvillimin, por dhe konkurrencën në treg mbi parimet e etikës.**

acies and build relationships factors in the their ethical boundaries in their work. He said the way they act affects not only their personal careers of everyone – including the people they work with – but also ultimately the company's goals.

Deputy Minister of Justice Toni Gogu also spoke at the conference, focusing on the principles of doing business in Albania and how the legislation and regulators affect the development of a fair and ethical relationship not only in the business world but also in the public administration.

According to Mr. Gogu, systems are constructions that will not stand if they do not have strong foundations.




But no matter how effective these systems are, he added, ultimately it is the people implementing them -- with their behavior and backgrounds – that determine whether a system produces success or not. Speaking about the work that has been done to set up regulatory systems that regulate labor relations and lay ethical foundations, Mr. Gogu mentioned the drafting of the Law on Conflict of Interest and the Law on Public Companies. Recently, the government also adopted the Law on Whistleblowers, which gives employees the opportunity to inform authorities when they see behaviors or actions that fall outside moral and ethical standards. "Building virtuous and ethical behaviors should come from the cooperation and respect we should have for each other -- regulatory systems simply facilitate this," Mr. Gogu said in his remarks.

Olindo Shehu, Tax and Legal Partner at Deloitte Albania and Kosovo, brought a business viewpoint and explained how Deloitte implements the Code of Business Ethics in relation to all stakeholders and spoke about the wealth of experience Deloitte has gathered around the world on this topic. While the rules determine whether actions are wrong or right, ethics go beyond a simple system of rules, he added. They impact human relationships but also set standards that shape a company's image.

> These beliefs affect who we are and what we want to become and help your business grow," **Mr. Estruth** *said at the conference.*







> *According to* **Mr. Gogu**, systems are constructions that will not stand if they do not have strong foundations.

> While the rules determine whether actions are wrong or right, ethics go beyond a simple system of rules, he added." *said* **Mr. Olindo Shehu**



moral dhe etik që prek individin, por që afekton gjithë sh`oqërinë dhe për rrjedhjojë edhe biznesin, z. Estruth u shpreh se mënyra se si ne mbështetemi në trashëgiminë tonë dhe ndërtojmë marrëdhënie për të cilat duam të kujtohemi, është dhe mënyra që përcakton kufijtë tanë etikë të punës. Mënyra se si ne sillemi ndikon jo vetëm në karrierën personale të gjithsecilit, por edhe në raportet me njerëzit me të cilët punojmë, dhe në fund edhe në objektivat që ka kompania.

**Janë bindjet ato që ndikojnë në çfarë jemi dhe çfarë duam të bëhemi,** dhe kjo ndihmon për të zhvilluar edhe biznesin tuaj " – u shpreh gjatë takimit z. Estruth.

Sipas z. Gogu, sistemet janë ndërtime të cilat **nuk do të qëndrojnë dot në këmbë nëse nuk kanë baza të forta.**

...ndërsa rregullat përcaktojnë mënyrën e veprimeve, nëse janë të drejta apo të gabuara, **etika është përtej një sistemi të thjeshtë rregullash"**- theksoi z. Olindo Shehu.

Z. Toni Gogu, Zëvendësministri i Drejtësisë ishte gjithashtu i pranishëm në këtë konferencë dhe foli për parimet e të bërit biznes në Shqipëri dhe se si ndikojnë legjislacioni dhe sistemet rregullatore në ndërtimin e një marrëdhënieje korrekte dhe me etikë jo vetëm në biznes, por edhe në administratën publike.

Sipas z. Gogu, sistemet janë ndërtime të cilat nuk do të qëndrojnë dot në këmbë nëse nuk kanë baza të forta. Por sado sisteme efikase të krijosh, në fund ato do të zbatohen nga njerëzit dhe janë pikërisht ata që me sjelljen dhe formimin e tyre e bëjnë të suksesshëm ose jo një sistem. Duke folur për punën që është bërë për të ngritur sisteme rregullatore që rregullojnë marrëdhëniet e punës dhe vendosin bazat e etikës, z. Gogu përmendi përgatitjen e ligjit për konfliktin e interesit si dhe ligjin për shoqëritë publike. Së fundi, qeveria ka miratuar dhe ligjin për sinjalizuesit, që i jep mundësi punonjësve të informojnë kur shikojnë sjellje apo veprime jashtë moralit dhe etikës. "Ndërtimi i një sjelljeje të virtytshme dhe me etikë duhet të vijë nga bashkëpunimi dhe nga respekti që duhet të kemi për njëri-tjetrin, ndërsa sistemet rregullatore thjesht e nxisnin këtë" – u shpreh z. Toni Gogu gjatë fjalës së tij.

Z. Olindo Shehu, Tax & Legal Partner i Deloitte Albania & Kosovo, solli një pikëpamje të biznesit dhe shpjegoi mënyrën se si Deloitte e zbaton Kodin e Etikës në biznes në lidhje me të gjitha palët e interesuara dhe foli për përvojën e tij nëpërmjet Deloitte në mbarë botën. Ai theksoi se ndërsa rregullat përcaktojnë mënyrën e veprimeve, nëse janë të drejta apo të gabuara, etika është përtej një sistemi të thjeshtë rregullash. Ajo ndikon në marrëdhëniet njerëzore, por njëkohësisht vendos standardet në veprimtarinë e një kompanie.




# CEO Forum hosts Finance and Economy Minister Anila Denaj

The CEO Forum of the American Chamber of Commerce in Albania has hosted new Finance and Economy Minister Anila Denaj at its first meeting of the year. CEOs of AmCham's largest members attended the roundtable discussion between business representatives and Minister Denaj. The meeting provided a venue for an exchange of views on a more fruitful business-administration cooperation.

Former AmCham President Mark Crawford spoke about the business climate in the country, mentioning that it is necessary to improve legislation in order to strengthen the financial market, making sure there is a legal package in this area that makes Albania competitive in the region. Finance and Economy Minister Denaj spoke about the policies the institution she leads is implementing to bring about qualitative changes in tax procedures through simplification and offering more efficient services to businesses. AmCham aims to create a business climate that promotes fair competition among businesses, and cooperation with the government in general and the administration of the Ministry of Finance and Economy in particular can help the fight against informality and tax evasion to reach that goal. Increasing institutional collaboration and developing discussions have an ideal venue in expert working groups. Such a practice has existed for some time, and AmCham would like to consolidate it further. During the meeting, AmCham representatives discussed the issues that affect the implementation of laws on VAT, Tax Procedures and Income Tax. These had also been discussed with customs and tax officials in other meetings and remain the focus of AmCham, including at the latest meeting with the Ministry of Finance and Economy.

> Finance and Economy Minister Denaj spoke about the policies the institution she leads is implementing to bring about qualitative changes in tax procedures through simplification and offering more efficient services to businesses.

### ISSUES DISCUSSED AT THE MEETING BETWEEN THE CEO FORUM AND FINANCE AND ECONOMY MINISTER ANILA DENAJ

**Cooperation** with the government in general and the administration of the Ministry of Finance and Economy in particular for the fight against informality and tax evasion is one of AmCham's objectives in order to create a business climate that promotes fair competition between businesses.

**The Fiscal Package** and issues affecting the implementation of laws on VAT, Tax Procedures and Income Tax -- also discussed with customs and tax officials -- remain the focus of AmCham, including in relation to the Ministry of Finance and Economy.

**The Fiscal Package** drafting process is supposed to get easier, with discussion starting in June, and AmCham wants to be involved in this process, but, on the other hand, the chamber has asked to be informed in a timely manner and to be given a real opportunity to provide comments based on the opinion of its members and experts.

**Increasing institutional collaboration** and developing discussions have an ideal venue in expert working groups. Such a practice has existed for some time, and AmCham would like to consolidate it further.







# Forumi i CEO-ve mirëpret Ministren e Financave dhe të Ekonomisë, znj. Anila Denaj

Forumi i CEO-ve i Dhomës Amerikane ka mirëpritur në takimin e parë të vitit, Ministren e re të Financave dhe Ekonomisë, znj. Anila Denaj. Takimi i organizuar me prezencën e CEO-ve më të lartë të Dhomës Amerikane, ishte një tryezë e rrumbullakët dialogu mes biznesit dhe Ministres Denaj dhe një shkëmbim opinionesh mbi një bashkëpunim më të frytshëm biznes - administratë.

Ish Presidenti i Dhomës Amerikane, z. Mark Crawford, gjatë fjalës së tij për klimën e biznesit në vend, përmendi faktin se është e nevojshme të bëhen përmirësime ligjore në forcimin e tregut financiar dhe Shqipëria të ketë një paketë ligjore që e bën konkurrente edhe në rajon. Ministrja e Financave dhe Ekonomisë, znj. Anila Denaj, foli për politikat që po zbaton institucioni i saj, për të sjellë një ndryshim cilësor në procedurat tatimore nëpërmjet thjeshtimit të tyre dhe shërbimit më me efikasitet për biznesin. Bashkëpunimi me qeverinë në përgjithësi dhe me administratën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në veçanti, për luftën kundër informalitetit dhe evazionit fiskal, është një nga objektivat e Dhomës Amerikane për krijimin e një klime biznesi që promovon konkurrencën e ndershme ndërmjet bizneseve. Rritja e bashkëpunimit institucional për të zhvilluar dialogun janë grupet e punës në nivel ekspertësh. Një praktikë e tillë pune ka ekzistuar dhe ne dëshirojmë ta konsolidojmë më tej. Gjatë takimit, është folur edhe për çështjet që prekin zbatimin e ligjeve si TVSH-ja, Procedurat Tatimore, Tatimi mbi të Ardhurat, të cilat janë diskutuar dhe ridiskutuar në takimet me Doganat dhe Tatimet, Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë dhe vazhdojnë të mbeten në fokusin e Dhomës.

> “Ministrja e Financave dhe Ekonomisë, znj. Anila Denaj, foli për politikat që po zbaton institucioni i saj, për të sjellë një ndryshim cilësor në procedurat tatimore nëpërmjet thjeshtimit të tyre dhe shërbimit më me efikasitet për biznesin.

## ÇËSHTJET QË U DISKUTUAN NË TAKIMIN E FORUMIT TË CEO-VE ME MINISTREN E FINANCAVE DHE EKONOMISË ZNJ. ANILA DENAJ

**Bashkëpunimi** me qeverinë në përgjithësi dhe administratën e Financave dhe të Ekonomisë në veçanti, për luftën kundër informalitetit dhe evazionit fiskal, si një nga objektivat e Dhomës Amerikane për krijimin e një klime biznesi që promovon konkurrencën e ndershme ndërmjet bizneseve;

**Paketa Fiskale** dhe çështjet që prekin zbatimin e ligjeve nga TVSH-ja, Procedurat Tatimore, Tatimi mbi të Ardhurat, janë diskutuar dhe ridiskutuar në takimet me Doganat dhe Tatimet, Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë dhe vazhdojnë të mbeten në fokusin e Dhomës;

**Lehtësitë** që duhet të vijnë nga hartimi i Paketës Fiskale, diskutimi fillon në qershor dhe Dhoma Amerikane dëshiron të përfshihet në këtë proces, por nga ana tjetër kërkon që edhe të informohet në kohë dhe t'i jepet mundësia reale për komente të mbështetura në mendimin e anëtarëve dhe të ekspertëve;

**Rritja e bashkëpunimit** institucional për të zhvilluar dialogun janë grupet e punës në nivel ekspertësh. Një praktikë e tillë punë ka ekzistuar dhe ne dëshirojmë ta konsolidojmë më tej.







# AmCham holds Working Breakfast with Minister Shalsi

The American Chamber of Commerce in Albania organized a Working Breakfast meeting with the Minister of State for the Protection of Entrepreneurship, Eduard Shalsi. Former AmCham President Mark Crawford, members of the AmCham Board and heads of the chamber's committees discussed with Minister Shalsi about avenues of cooperation to facilitate the work of businesses through a stable business climate not only for domestic businesses but also for foreign investors.

The meeting provided AmCham with the opportunity to familiarize itself with Mr. Shalsi's work, which aims to create strong bridges of cooperation with all business organizations in order to receive concerns and forward them to the appropriate institutions for solutions. Mr. Shalsi said he feels there is need to create a detailed database containing all businesses, divided by sector, and set up constant communication with them as a good foundation for mediating problems.

"It is indispensable to create a business register that will help us not only have businesses registered by sector, but also have up-to-date contact information to have the opportunity to communicate on a continuing basis with all the businesses on every issue they have," Minister Shalsi said, adding that he plans to send out an email message every week to business leaders, divided by sector, to seek information on how business is going and whether the companies have any needs. Many means of communication -- from the website to SMS -- are available and functional and help strengthen the relations, cooperation and communication. The Working Breakfast is one of those "communication tools" that allows Mr. Shalsi to speak directly to AmCham members and get feedback on how AmCham views the the business climate and what its members need. AmCham representatives focused their discussion on policy issues that can develop and strengthen the investment climate and make the country more attractive to foreign and domestic businesses. AmCham's new President, Enio Jaço, said following the discussion with Mr. Shalsi that the chamber is a government partner in strengthening the business climate and is willing to cooperate to help create a sustainable atmosphere that favors foreign investment and domestic businesses. The foundation of creating that climate together is dialogue and cooperation, Mr. Jaço said.

> Mr. Shalsi said he feels there is need to create a detailed database containing all businesses, divided by sector, and set up constant communication with them as a good foundation for mediating problems.

Alketa Uruçi, Chairwoman of the Tax and Customs Committee, spoke about her experience of co-operating with institutions in her capacity as committee head and the role the chamber plays as a lobbying organization for legal and regulatory improvements. Institutions that draft laws and bring them for comments should leave enough time for discussion. It is often the case that they are made available at the last moment, leaving little time for a real and concrete discussion, she said. Ms. Uruçi also spoke about the recent issues AmCham has worked on to make it easier to do business in Albania, improving the business climate. Tax investigations and risk methodology, tax evasion and property issues were some of the topics AmCham has addressed with its experts and has sought cooperation on with state institutions.




# Dhoma Amerikane, Mëngjes Pune me Ministrin Shalsi

Dhoma Amerikane e Tregtisë ka organizuar takimin 'Mëngjes Pune' me Ministrin e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, z. Eduard Shalsi. Ish Presidenti i Dhomës, z. Mark Crawford, anëtarë të Bordit Drejtues të Dhomës dhe drejtues të Komiteteve, kanë diskutuar me Ministrin Shalsi mbi mënyrat e bashkëpunimit institucional, për të lehtësuar punën e biznesit dhe për të krijuar një klimë të qëndrueshme jo vetëm për biznesin vendas, por edhe për investitorët e huaj.

Takimi i ka dhënë mundësinë Dhomës Amerikane të njihet me punën që është duke bërë z. Shalsi, për të krijuar ura bashkëpunimi të forta me të gjitha strukturat e biznesit dhe më pas, informacionin dhe çështjet që merr prej tyre t'i delegojë në institucionin e duhur. Z. Shalsi ka shpjeguar se ndjen nevojën e një databaze të hollësishme për të gjitha bizneset të ndarë sipas sektorëve dhe të një komunikimi të vazhdueshëm me ta, si një bazë e mirë për të ndërmjetësuar për problematikat e tyre.

"Është i domosdoshëm krijimi i një regjistri të biznesit, i cili do të na ndihmonte jo vetëm t'i kemi bizneset të regjistuara sipas sektorëve, por dhe të kemi të dhëna të përditësuara të tyre, në mënyrë që të kemi mundësi të komunikojmë në vijimësi me të gjitha bizneset për çdo çështje që ata kanë"- u shpreh Ministri Shalsi, i cili shpjegoi se në planin e tij të punës do që t'i drejtohet me një e-mail çdo javë drejtuesve të bizneseve të ndarë sipas sektorëve, për t'i kërkuar informacion për mënyrën se si procedojnë me biznesin dhe nevojat që kanë. Mjetet e komunikimit që nga website-i e deri tek sms-ja janë të gjitha funksionale dhe të pranueshme për të forcuar këtë marrëdhënie bashkëpunimi dhe këto ura komunikimi. Mëngjesi i punës është një nga ato "mjete komunikimi" që i lejon z. Shalsi të flasë drejt për drejt me anëtarët e Dhomës dhe të marrë *feedback* mbi mënyrën se si e vlerëson Dhoma Amerikane klimën e biznesit dhe çfarë kanë nevojë anëtarët.

> Z. Shalsi ka shpjeguar se ndjen nevojën e një databaze të hollësishme për të gjitha bizneset të ndarë sipas sektorëve dhe të një komunikimi të vazhdueshëm me ta, si një bazë e mirë për të ndërmjetësuar për problematikat e tyre.

Diskutimi i përfaqësuesve të Dhomës Amerikane është fokusuar në çështjet parimore që zhvillojnë dhe forcojnë klimën e investimeve dhe e bëjnë vendin më atraktiv për biznesin e huaj dhe atë vendas. Presidenti i ri i AmCham-it, z. Enio Jaço, në vijim të diskutimit me z. Shalsi, theksoi se Dhoma është një partner i qeverisë në forcimin e klimës së biznesit dhe është e gatshme të bashkëpunojë, për të ndihmuar në krijimin e një atmosfere të qëndrueshme që favorizon investimet e huaja dhe biznesin vendas. Baza për të ndërtuar bashkarisht këtë klimë është dialogu dhe bashkëpunimi, u shpreh z. Enio Jaço.

Znj. Alketa Uruçi, Kryetare e Komitetit të Taksave dhe Doganave, foli për eksperiencën e saj të bashkëpunimit me institucionet në cilësinë e Kryetares së Komitetit dhe për rolin që ka Dhoma si organizatë që lobon për përmirësimet ligjore dhe rregullatore. Institucionet që hartojnë ligjet dhe i sjellin ato për komente duhet të kenë në konsideratë se duhet një kohë e mjaftueshme për diskutim. Vazhdimisht ndodh që ato vijnë në momentet e fundit duke i lënë pak kohë biznesit për një diskutim real dhe konkret. Znj. Alketa Uruçi foli gjithashtu për çështjet e fundit mbi të cilat Dhoma Amerikane ka punuar për të lehtësuar aktivitetin e biznesit në vend dhe për të përmirësuar për rrjedhojë edhe klimën e biznesit. Hetimi tatimor dhe metodologjia e riskut, çështjet e evazionit fiskal dhe çështjet e pronave kanë qenë ndër temat që ka trajtuar AmCham-i me ekspertët e saj dhe ka kërkuar bashkëpunim me institucionet shtetërore.













## AmCham organizes Business Forum on

# EMPLOYMENT AND PROFESSIONAL DEVELOPMENT

## Businesses, schools and government join roundtable on solutions

The American Chamber of Commerce in Albania has paid special attention to the topics of employability and the development of a professional workforce, bringing together at the same roundtable all main market actors dealing with these issues. AmCham's Labor and Ethics Committee, chaired by Roden Pajaj, organized a Business Forum that helped businesses from an array of sectors to speak to representatives of vocational schools about addressing the market challenge of a lack of a professional workforce as well as discussing how both sides can respond to find long-term solutions to this problem. A government representatives also joined the discussion, bringing her point of view on how the government can help with tailored policies and work together with market stakeholders on developing a strong professional workforce that meets the market's needs.

> Along with the government, donor organizations have also turned their attention toward vocational schools, understanding that investing in these schools is actually an investment in the creation and development of a new generation of skilled workers.

Silvana Banushi, Director of Employment and Professional Development, spoke about the government's efforts by referring to its higher investments in infrastructure and curricula that aim to make vocational school an attractive and "fashionable" choice. Along with the government, donor organizations have also turned their attention toward vocational schools, understanding that investing in these schools is actually an investment in the creation and development of a new generation of skilled workers.

Mr. Pajaj moderated the AmCham-organized roundtable, opening the discussion by asking representatives of businesses and vocational schools how they viewed the current job market. NOA's representative, Blerina Krantja, expressed concern that when selecting students and candidates through the interview process, it takes 200 interviewees to get two hires, something that makes her think schools should do more to prepare their students for the job market.

Harry Fultz Institute's representative, Reshard Këlliçi, said there is a need for businesses to approach the vocational schools directly to find good candidates, as they are ready and willing, and, meanwhile,



Dhoma Amerikane, Forum Biznesi për

# PUNËSIMIN DHE ZHVILLIMIN PROFESIONAL

## Bizneset, shkollat dhe qeveria në një tryezë pune për zgjidhje

Dhoma Amerikane e Tregtisë i ka kushtuar kujdes të veçantë temës së punësueshmërisë dhe zhvillimit të forcave profesionale, duke ulur në një tryezë pune të gjithë aktorët e tregut që influencojnë në këtë drejtim. Komiteti i Punës dhe i Etikës, i drejtuar nga z. Roden Pajaj, ka organizuar Forumin e Biznesit, që ka vënë përballë bizneset e sektorëve të ndryshëm me përfaqësues të shkollave profesionale, për të diskutuar mbi mënyrën se si ata e shohin problematikën e krijuar në treg nga mungesa e forcave profesionale të punës dhe se si duhet të reagojnë të dyja palët, për t'i dhënë zgjidhje afatgjatë këtij problemi. Në diskutim është përfshirë dhe një përfaqësues i qeverisë, i cili ka sjellë këndvështrimin e vet për mënyrën se si qeveria ndërhyn me politika dhe ndërvepron me aktorët në treg, për të zhvilluar forca profesionale që i përgjigjen nevojave të tregut.

Znj. Silvana Banushi, Drejtoreshë për Punësimin dhe Zhvillimin Profesional, duke folur për punën që ka bërë qeveria, iu referua investimeve në rritje jo vetëm të infrastrukturave, por dhe të kurrikulave që po e rikthejnë "në modë" shkollën profesionale. Ndërkohë, në krah të qeverisë janë pozicionuar edhe donatorët, të cilët kanë kthyer sytë nga shkollat profesionale, duke kuptuar se investimi tek këto shkolla është një investim në formimin dhe zhvillimin e gjeneratave të reja të punës.

Tryeza e rrumbullakët e organizuar nga Dhoma Amerikane është moderuar nga z. Pajaj, i cili ka hapur diskutimin mbi mënyrën se si e shikojnë për momentin tregun e punës bizneset dhe shkollat profesionale. Përfaqësuesja e kompanisë NOA, znj. Blerina Krantja, ka shprehur shqetësimin se nga intervistat që bëjnë me studentët dhe kandidatët për punësim, arrijnë të përzgjedhin 2 nga 200 të intervistuar, çfarë i bën ata të mendojnë se shkollat duhet të angazhohen më shumë për formimin e tyre.

> Ndërkohë, në krah të qeverisë janë pozicionuar edhe donatorët, të cilët kanë kthyer sytë nga shkollat profesionale, duke kuptuar se **investimi tek këto shkolla është një investim në formimin dhe zhvillimin e gjeneratave të reja të punës.**

Përfaqësuesi i Institutit Harry T. Fultz, z. Reshard Këlliçi ka shtruar nevojën se bizneset sot duhet të afrohen pranë shkollave profesionale dhe t'i gjejnë atje kandidatët, pasi i kanë të gatshëm dhe ndërkohë



companies should also realize that investing directly into these schools will lead to getting properly qualified staff. "All businesses are in the marketplace to make a profit. What unites us is the need for cooperation so we can work with professionals to educate the next generations and you [businesses] can benefit from this," Mr. Këlliçi said in his remarks.

Fation Dragoshi, the Swisscontact representative, furthered the idea that the vocational schools and curricula they develop and use should be the primary focus, and Swisscontact has already already begun to work in this direction in places like the Gjergji Canco School. The Austrian School of Shkodra also brought its experience on how the teaching staff works to develop curricula that help students be ready for the job market and become specialized as early as their high school years. The Gjergj Canco School representative also explained how it works together with donor organizations to increase the school's capacities and orient students toward businesses as well as shape their skills to be market-ready.

The discussion also focused on how different economy sectors are reflecting their need for a skilled labor force, including the growing tourism sector. Gladila Dona of the Tourism and Hospitality Academy brought her experience on how they train and shape their candidates to become receptionists, wait staff and managers for a quality-oriented tourism market. The second panel discussion involved AmCham members who wanted to have more information on how these schools cooperate with businesses in different sectors and how companies looking for professionals can create a better way of working together with the schools.

***The discussion also focused on how different economy sectors are reflecting their need for a skilled labor force, including the growing tourism sector.***

***Diskutimi është përqendruar edhe tek mënyra se si sektorët e ekonomisë kanë filluar të reflektojnë kërkesën për forca pune dhe turizmi është një prej tyre.***



duhet të kuptojnë se vetëm duke investuar drejt për drejt mbi këto shkolla do të arrijnë të formojnë stafe të kualifikuara. "Në treg të gjitha bizneset dalin për të fituar, ajo që na bashkon është nevoja e bashkëpunimit që ne të punojmë me profesionistë, për të edukuar gjenerata dhe ju të përfitoni nga kjo" - u shpreh në fjalën e tij z. Këlliçi.

Përfaqësuesi i Swiss Contact, z. Fation Dragoshi, përforcoi akoma edhe më shumë idenë, se shkollat profesionale dhe kurrikulat që ato zhvillojnë duhet të jenë në qendër të vëmendjes, dhe programi i tyre tashmë ka filluar ta bëjë ketë me shkolla si Gjergji Canco. Pjesë e diskutimit ka qenë edhe shkolla Austriake në Shkodër, që ka sjellë eksperiencën e vet për mënyrën se si stafi pedagogjik punon për të formuar nëpërmjet kurrikulave nxënës që janë të gatshëm për tregun dhe që marrin që në shkollë të mesme një orientim për profesionin e tyre. Përfaqësuesi i shkollës Gjergji Canco ka folur gjithashtu për mënyrën se si kjo shkollë bashkëpunon me organizatatat donatore, për të rritur kapacitetet e shkollës dhe se si i orienton nxënësit drejt biznesve dhe i formon për tregun.

Diskutimi është përqendruar edhe tek mënyra se si sektorët e ekonomisë kanë filluar të reflektojnë kërkesën për forca pune dhe turizmi është një prej tyre. Znj. Gladila Dona nga Turizëm & Hospitality Akademi, ka sjellë eksperiencën e saj mbi mënyrën se si i trajnojnë dhe formojnë kandidatët e tyre për të qenë kamarierë, recepsioniste, menaxherë të denjë për tregun e turizmit. Diskutimi i panelit të dytë ka patur edhe ndërhyrjen e anëtarëve të Dhomës Amerikane, të cilët kanë dashur të kenë më shumë informacion mbi mënyrën se si këto shkolla bashkëpunojnë me biznesin e sektorëve ku formojnë profesionistë dhe se kush do të jetë mënyra më e mirë e bashkëpunimit mes tyre.

# WELCOME
## new members

## ERMIR VEIPI PF

*SHORT BUSINESS PROFILE*
**Ermir Veipi** - Legal Auditor. Provides Legal Audit Service as well as other related services. Provides services of legal, fiscal and accounting consultancy, preparation of financial statements, etc., within the legal framework of the lack of conflict of interest during his profession performance.

Representative: Ermir Veipi
Legal Auditor
Address: Njësia Bashkiake Nr. 7, Blvd. Gjergj Fishta, Pall. Gorra Sh.p.k., Kulla 2, Kati 10, Nr. 49, Tiranë
Contacts: +355 (0) 686016860
ermirveipi@gmail.com
Activity: Accounting Services,
Legal Audits and Related Services

ermirveipi@gmail.com

## ets energy & telecomunication systems

*SHORT BUSINESS PROFILE*
**ETS Company** was established in 2001, with its activity throughout Albania. The purpose of the ETS establishment in Albania was to provide alternatives to the uninterrupted provision of electricity supplies to power corporation, various government institutions and public service companies. Main activity of ETS Sh.p.k. is in the field of power supply with electrical equipment and works for low, medium and high voltage.

Representative: Fatos Aliaj, Owner
Other contact: Shefki Dema, Managing Director
Address: Rruga Jordan Misja, ish Magazinat e UMB-së, përballë shtypshkronjës Demokracia, Tiranë
Contacts: +355 (0) 4 23 45 122, Mobile: +355 (0) 674 053 010
faliaj@ets-al.com
Activity: Electrical Supplies & Works

www.ets-al.com

## Exatto
Anticipare Allineare Agire

*SHORT BUSINESS PROFILE*
**Exatto Sh.p.k.** is a company that has been operating in Albania for more than 11 years. It is part of Group 2B1 with 3 offices in Italy. Its business activity is Accounting, HR & Payroll, Data Quality Management, BPO & FAO. Exatto Company is considered a great opportunity for the newly graduates as well as those with experience, offering a unique experience for a strong professional growth.

Representative: Massimiliano Baiocco – Administrator
Stefano Argieri, Operations Director
Irena Filipi, Human Resources Manager
Address: Farkë e Vogël, Sauk, Tiranë
Contacts: +355 (0) 676022479
ifilipi@exatt-o.com
Activity: Business Outsourcing, Accounting, HR & Payroll, FAO & BPO, Data Quality Management.

www.exatt-o.com

## GALLERY70 CONTEMPORARY ART

*SHORT BUSINESS PROFILE*
**Gallery70** is a modern and contemporary private art gallery inviting art lovers, businesses and art collectors to discover and possess art. We work with you selecting artworks that will make your space inspiring, powerful and unforgettable. Located at the heart of Tirana, ground floor at Toptani Shopping Center.

Gallery 70 Contemporary Art
Representative: Lauresha Basha
Administrator: Gjon Kraja
Address: Rr. Abdi Toptani, Toptani Center, Tiranë
Contacts: +355 (0) 682041859, (0) 692041859
info@gallery70.art
Activity: Creative Industry. Art Gallery

www.gallery70.art





RESHARD KËLLIÇI

OLSI ÇOKU





ENED TOPI



VALBONA JAUPLLARI

ALBERT GRUDA





# Industrial property rights: Monitoring the market



NERITAN FRASHËRI

FERIK KARASANI



## Business Forum with the State Market **Monitoring Inspectorate**

The Legal, Regulatory and IPR Committee of the American Chamber of Commerce in Albania, led by Kledi Kodra, organized a Business Forum with the Chief Inspector of the State Market Monitoring Inspectorate, Valbona Jaupllari, and her staff to talk about the methodology and rules the institution will use to carry out inspections on industrial products in the market as well as its work on the protection of industrial and intellectual rights.

Mark Crawford, former AmCham President, spoke about the importance of the inspectorate and its regulatory role in protecting business and consumer rights. Speaking on the importance of market inspections, Mr. Crawford said that businesses in the United States pay their taxes properly and ultimately expect the following of the rules of the game, especially when it comes to protecting their industrial property rights, copyrights, trademarks and patents -- things that need to be preserved by institutions in charge to monitor the market against abuse.

Legal, Regulatory and IPR Committee Chairman Kledi Kodra explained the focus of the committee on the protection of brands and patents as well as the recognition and respect of copyright as necessary conditions for the development of a business climate that is conducive and safe for investments.

Chief Inspector Valbona Jaupllari explained that the institution she leads is new, but it has focused on inspecting the market in order to make sure fake products do not reach customers as well as that all products are sold in compliance with regulations. According to Ms. Jaupllari, the inspectorate conducts its work based on specific legislation applicable to this particular area. The Ministry of Finance and Economy drafts policies and legal acts




# Pronësia Industriale, si kontrollohet tregu

## Forumi i Biznesit me Inspektoriatin Shtetëror për **Mbikëqyrjen e Tregut**

Komiteti "Regulatory, Legal & IPR" i Dhomës Amerikane, i drejtuar nga z. Kledi Kodra, organizoi një Forum Biznesi me Kryeinspektoren e Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, znj. Valbona Jauplari dhe stafin e saj, për të folur për metodologjinë dhe rregullat mbi të cilat do të kryhet inspektimi për produktet industriale në treg, si edhe për mbrojtjen e të drejtave industriale dhe intelektuale.

Z. Mark Crawford, ish Presidenti i AmCham, foli për rëndësinë e inspektimit dhe rolin rregullator në mbrojtjen e të drejtave të biznesit dhe të konsumatorëve. Duke folur për rëndësinë që kanë inspektimet në treg, z. Crawford kujtoi se bizneset në Amerikë paguajnë taksat në rregull dhe në fund presin që rregullat e lojës, sidomos kur vjen fjala për respektimin e të drejtave të tyre industriale, të drejtat e autorit, markat dhe patentat, të jenë të ruajtura nga institucionet që i monitorojnë ato.

Kryetari i Komitetit "Regulatory, Legal & IPR", z. Kledi Kodra, ka shpjeguar fokusin që ka ky Komitet në respektimin e markave dhe patentave, njohjen dhe respektimin e të drejtave të autorit si një kusht i nevojshëm për zhvillimin e klimës së biznesit, dhe sidomos si një nevojë për të siguruar një ambient të sigurtë për investimet e huaja.

Kryeinspektorja e ISHMT-së, znj. Valbona Jauplari, shpjegoi se institucioni që ajo drejton është i ri, por ka patur në fokus të punës inspektimin dhe vendosjen nën kontroll të tregut, për të mos lejuar që produkte 'fake' të arrijnë tek konsumatori, si edhe për të siguruar se ato shiten konform të gjitha rregullave. Sipas znj. Jauplari, ISHMT-ja ushtron veprimtarinë e saj në zbatim të legjislacionit të posaçëm të zbatueshëm sipas fushës së veprimtarive. MFE-ja harton politikat dhe



on market inspections and then the inspectorate is responsible for their implementation.

But even though inspections are carried out, businesses looking to protect their trademarks must file complaints with the inspectorate to inform it that competing businesses are selling products for which they are not the copyright holders. The situation is even more complicated when, due to the law, the inspectorate has no legal remedy to stop the activity of these businesses, but the owner of the rights has to go court instead. Chief Inspector Jaupllari explained that the inspectorate website contains a special section "where every citizen or subject can complete the complaint form which is then handled by the responsible structures."

During their market oversight, the inspectors have been keen to understand legal deficiencies sought to convince businesses to stop their violations in this area. Informing companies on the need to recognize and respect intellectual and industrial property rights in the non-food group products -- the focus of operations for the inspectorate -- has been one of the institution's top tasks.

"We are not aiming to issue fines, that's the last resort after taking steps to inform businesses, to let them know,"

***Ms. Jaupllari said.***

While the inspectorate itself faces challenges with its staff structure and the small number of inspectors available, it has also noted businesses are not trying hard enough to be informed on the latest legislation. "It is necessary for them to be informed of the rights and obligations they have when an inspector conducts a screening, so they are prepared," Ms. Jaupllari said at the meeting.

## HOW INSPECTIONS WORK

***Type of inspection***

Scheduled inspection (as a rule, the subject is notified three days prior to inspection)

Unprogrammed inspection

***Administrative measures***

Warning / minor misconduct

Fine (Law on Inspection provides for a fine of 10,000 to 100,000 leks, mainly for cases of obstruction of inspection.)

***Urgent measures***

1) termination of the performance of an action, activity or part of an activity;
2) stopping operation of the installation of a machine or appliance;
3) blocking and stopping access to the premises of the activity;
4) seizing and taking over for administration of animals, plants, goods, machinery, products or items;
5) temporary ban on entry into the territory of the country of animals, plants, goods, machinery, products or articles;
6) ordering the subject of the inspection to notify third parties or the public about possible risks;
7) any other measure deemed necessary and proportionate to achieve the purpose of the urgent measure.



## SI FUNKSIONON INSPEKTIMI

***Lloji i Inspektimit***
Inspektim i programuar (si rregull, njoftohet subjekti 3 ditë përpara inspektimit)
Inspektim i paprogramuar

***Masat Administrative***
Paralajmërim / shkelje e rëndësisë së vogël
Gjobë (Ligji i inspektimit parashikon masë nga 10 000 – 100 000 lekë kryesisht për rastet e pengimit të inspektimit)

***Masat Urgjente***
a) ndërprerja e kryerjes së një veprimi, veprimtarie apo një pjese të saj;
b) ndalimi i funksionimit të një instalimi, makinerie apo pajisjeje;
c) bllokimi dhe ndalimi i hyrjes në mjediset e ushtrimit të veprimtarisë;
ç) bllokimi dhe marrja në administrim e kafshëve, bimëve, mallrave, makinerive, produkteve apo sendeve;
d) ndalimi i përkohshëm i hyrjes në territorin e vendit të kafshëve, bimëve, mallrave, makinerive, produkteve apo sendeve;
dh) urdhërimi i subjektit të inspektimit të njoftojë të tretët apo publikun për rreziqet e mundshme;
e) edhe çdo masë tjetër që vlerësohet e domosdoshme dhe proporcionale për të realizuar qëllimin e masës urgjente.

aktet ligjore/nënligjore në fushën e mbikëqyrjes së tregut, ISHMT-ja ka përgjegjësi për zbatimin e tyre.

Por edhe pse inspektimet funksionojnë, bizneset për të ruajtur të drejtën e markës së tyre duhet të ankohen pranë Inspektoriatit, për të informuar që bizneset konkurrente po shesin produkte për të cilat nuk janë mbajtës të së drejtës. Situata duket edhe më e komplikuar kur për shkak të ligjit, Inspektoriati nuk ka tagrin ligjor të ndalojë aktivitetin e këtyre bizneseve, por duhet që vetë mbajtësi i së drejtës t'i drejtohet Gjykatës. Kryeinspektorja Jaupllari sqaroi se në web-in e ISHMT-së ka një rubrikë të posaçme "ku çdo qytetar apo subjekt mund të plotësojë formularin e ankesës, e cila më pas trajtohet nga strukturat përgjegjëse".

Gjatë inspektimeve të tyre, trupa e inspektorëve është e prirur të kuptojë mangësitë dhe shkeljet ligjore dhe t'i kërkojë bizneseve t'i korrigjojnë ato. Informimi i operatorëve ekonomikë në drejtim të njohjes dhe të respektimit të kritereve ligjore për grup-produktet jo ushqimore që janë në fokusin e veprimtarisë së këtij institucioni, ka qenë një nga detyrat e Inspektoriatit.

> "Nuk jemi të prirur drejt gjobave, kjo është masa e fundit që marrim duke kaluar disa hapa të informimit dhe të lajmërimit të biznesit" - *u shpreh znj. Jaupllari.*

Ndërsa vetë Inspektoriati ka problematika me organikën dhe numrin e vogël të inspektorëve, shoh që biznesi është indiferent ndaj informimit që duhet të ketë mbi ligjin. "Është e nevojshme që ata të jenë të informuar për të drejtat dhe detyrimet që kanë, pasi kur inspektori të shkojë për kontroll ata duhet të jenë të përgatitur" - u shpreh znj. Jaupllari gjatë takimit.





YLLI PULAJ

NERITAN FRASHËRI



ARBËR HABILI

RENATA LEKA

KLEDI KODRA





RESHARD KËLLIÇI



# "Standing together for IP rights"





SOFJAN JAUPAJ

ELVIN LAKO



## AmCham Albania speaks with stakeholders on the protection of **Intellectual Property Rights**

The American Chamber of Commerce in Albania organized a round table where the most important line institutions responsible of intellectual and industrial property rights were invited. Over the years, AmCham has organized regular meetings with key institutions that coordinated their work to better reach the goal of improving the IP situation in the domestic market.

The President of the American Chamber of Commerce, Mr. Enio Jaço appreciated the cooperation of the institutions in creating a stable market while at the same time asked for their commitment and collaboration to create an adequate climate to guarantee the implementation of intellectual property rights. Representatives of line institutions and AmCham members had the chance to discuss on trademark and patents, the ban of piracy, inspection process and enforcement of the Law Inspectorate.

"AmCham will focus on strengthening lobbying efforts for the improvement of the legal framework that protects industrial property rights, mainly on Market Inspection Law, cooperation with the National Food Authority Inspectorate, as one of the Inspectorates that broadly monitors the market and controls business operations in the market."

Director of Industrial Property Directorate, Mr. Elvin Lako explained in high level how the Directorate functions in registering and controlling trademarks and patents in Albania, both from the legal and practical point of view. "We have conducted individual visits in every business and enterprise to explain the registration of trademarks and patents and the obligations and rights deriving from the Law are a way of institutional cooperation," - stated Mr. Lako.




# Dhoma Amerikane flet me aktorët kryesore të mbrojtjes **së Pronësisë Intelektuale**

Dhoma Amerikane e Tregtisë ka mbledhur në një tryezë pune institucionet më të rëndësishme të linjës që mbulojnë çështjet e pronësisë intelektuale dhe industriale dhe kujdesen për respektimin e këtyre të drejtave. Në vite Dhoma Amerikane ka patur takime të rregullta me të gjithë institucionet që bashkërendonin praktikat e tyre të punës, për të koordinuar më mirë në qëllimin e përmirësimit të situatës së IP-së në tregun vendas.

Presidenti i Dhomës Amerikane të Tregtisë, z. Enio Jaço, ka vlerësuar bashkëpunimin e institucioneve për të krijuar një situatë të qëndrueshme në treg, duke kërkuar në të njëjtën kohë impenjimin e tyre që në bashkëpunim me biznesin të krijojnë parametrat optimalë për pronësinë intelektuale. Takimi ka qenë një bisedë e hapur e drejtuesve të institucioneve me anëtarët e Dhomës Amerikane mbi çështjet e respektimit të markave dhe patentave, ndalimit të piraterisë, funksionimit të inspektimit dhe zbatimit të ligjit nga Inspektoriatet.

"Dhoma do të fokusohet në fuqizimin e lobimit për përmirësimin e kuadrit ligjor për mbrojten e të drejtave të Pronësisë Industriale, kryesisht mbi Ligjin për Inspektimin e Tregut, bashkëpunimin edhe me Inspektoriatin e AKU-së, si një nga inspektoriatet që monitoron gjerësisht tregun dhe kontrollon një pjesë të konsiderueshme të biznesit".

Kreu i Drejtorisë së Pronësisë Industriale, z. Elvin Lako, ka shpjeguar për të gjithë pjesëmarrësit se si funksionon drejtoria që regjistron dhe kontrollon markat dhe patentat në vend, jo vetëm nga pikëpamja e ligjit, por edhe ajo praktike. "Jam përpjekur të bëj vizita individuale tek çdo kompani biznesi, për të shpjeguar konkretisht se si funksionon regjistrimi i markave dhe patentave dhe detyrimet dhe të drejtat që vijnë nga ligji si një formë e bashkëpunimit



Mr. Kledi Kodra, Chairman of the Legal, Regulatory & IPR Committee spoke about the work done so far to follow up the protection of intellectual rights from Customs Directorate, which is the gateway to the domestic market, to market inspections and the right implementation of Copyright. "Activating the stakeholders group as an opportunity to clearly address all members issues that will help AmCham to find the right channels to handle these issues," said Mr. Kodra.

The customs representative, Mr. Arber Halili, explained the work of the directorate to prevent piracy and fake products entering the market. "Only 10 percent of goods entering the market are subject to physical control, and this is followed by strong business pressure not to create more bureaucracy in the Customs. It creates a difficult situation for the Intellectual Property Directorate to ascertain any fake product entering the market," said Mr. Halili.

Mr. Neritan Frashëri from the Market Surveillance Inspectorate stated the level of inspections and controls delivered in the market, especially with regard to the software industry. 'There were around 386 controls in the market during 2018, and only 5 of them were oriented by the complaints that businesses have had," said Mr. Neritan Frasheri seeking business cooperation.

Director of Copyright at the Ministry of Culture, Mr. Sofjan Jaupaj, explained the role of this directorate in enabling the rigorous implementation of Copyright in all institutions responsible for market monitoring.

This stakeholder group meeting is in the wake of the meetings that AmCham started in 2019 with all line institutions. The national IPR Conference will revitalize and will focus on the issues of Market Inspection Law enforcement.

**ONLY**

**10 %**

of goods entering the market are subject to physical control, and this is followed by strong business pressure not to create more bureaucracy in the Customs. It creates a difficult situation for the Intellectual Property Directorate to ascertain any fake product entering the market," said Mr. Halili.

**VETËM**

**10 %**

e mallrave që vijnë në doganë i nënshtrohen kontrollit fizik, dhe kjo pas presionit të fortë nga biznesi për të mos krijuar burokraci në dogana. Kjo e bën të vështirë për Drejtorinë e Pronësisë Intelektuale të konstatojë çdo produkt fallco që hyn në treg" – u shpreh z. Habili.

institucional" - u shpreh z. Lako.

Z. Kledi Kodra, Kryetar i Komitetit të 'Regulatory, Legal & IPR' përmendi punën e bërë për të ndjekur të drejtën intelektuale nga doganat, e cila është porta hyrëse për në tregun vendas, e deri tek inspektimet në treg dhe aplikimi i ligjit të Copyright-it. "Aktivizimi i 'Stakeholders Group' është një mundësi për të adresuar qartë të gjitha problematikat që na vijnë nga anëtarët dhe Dhoma gjen kanalet e duhura për t'i trajtuar ato" – u shpreh z. Kodra.

Përfaqësuesi i Doganave, z. Arbër Habili, shpjegoi punën që bën drejtoria e tij për të parandaluar piraterinë dhe produktet fallco të hyjnë në treg. "Vetëm 10 për qind e mallrave që vijnë në doganë i nënshtrohen kontrollit fizik, dhe kjo pas presionit të fortë nga biznesi për të mos krijuar burokraci në dogana. Kjo e bën të vështirë për Drejtorinë e Pronësisë Intelektuale të konstatojë çdo produkt fallco që hyn në treg" – u shpreh z. Habili.

Z. Neritan Frashëri nga Inspektoriati i Mbikëqyrjes së Tregut foli mbi inspektimet dhe kontrollet që janë bërë në treg, sidomos për sa i takon industrive të software-ëve. "Ka patur 386 kontrolle në treg në 2018-ën dhe vetëm 5 prej tyre janë orientuar nga ankesat që kanë patur bizneset" – u shpreh z. Neritan Frashëri, duke kërkuar më shumë bashkëpunim nga biznesi.

Në takim ka qenë i pranishëm edhe përfaqësuesi i Drejtorisë së të Drejtës së Autorit në Ministrinë e Kulturës, z. Sofjan Jaupaj, i cili ka shjeguar rolin që kryhen kjo drejtori për të mundësuar që të gjitha institucionet që monitorojnë tregun të respektojnë të drejtën e autorit. Takimi i 'Stakeholders Group' është në vazhdën e takimeve që Dhoma ka filluar në 2019-ën me të gjitha institucionet e linjës, për të kulmuar në një Konferencë Kombëtare të IPR-it, e cila do të përqendrohet tek çështjet e inspektimit dhe zbatimit të ligjit.

# WELCOME
## new members

### GJIROFARM

*SHORT BUSINESS PROFILE*
**Gjirofarma** is one of the biggest diary companies in Albania and the absolute leader in production & trade of the authentic Albanian White Cheese since 2005. Gjirofarma is led by the passion to offer consumers an easier way to have access to high quality products which offer them more than what they expect. The entire production process has been certified according to ISO 22000:2005, which has included all the HACCP standards.

Representative: Nikolla Gjoni
Address 1: Autostrada Tiranë-Durrës, Km. 5, Rruga Dytësore, Tiranë
Address 2: Bodrishtë, Rruga Nacionale Gjirokastër-Kakavijë, Gjirokastër
Contacts: +355 (0) 696000193
ngjoni@gjirofarm.com
Activity: Diary

www.gjirofarm.com

### Invest Unlimited Albania Sh.p.k.

*SHORT BUSINESS PROFILE*
**Invest Unlimited Albania** is an Albanian real estate company founded in 2018. It is headquartered in Tirana, Albania. The company's prior focus is to bring foreign investors in the country as well as to provide Albanian investors the opportunity to invest overseas. Today the company has created a large portofolio of properties in Albania, USA, Greece, etc.

Invest Unlimited Albania Sh.p.k.
Representative: Kelvina Korreshi (Koxhaj)
Administrator
Address: Sheshi Willson, Pallati Nr. 14, Kati 2, Tiranë
Contacts: +355 (0) 4 4519651
koxhajkelvina@gmail.com
Activity: Real Estate. Intermediation in Property Sale and Rent

### KANTINA BARDHA

*SHORT BUSINESS PROFILE*
**Bardha Winery,** created by Ekrem Bardha with love and sacrifice produces wines of International standards, with elegant and fine taste, where you can feel a good harmony of aromas of flowers and fruits. Bardha Winery is proud of its wine, based on modern technology and in the ancient tradition of wine production.

Representative: Donika Bardha, Owner
Ekrem Bardha, Owner
Address: Rruga e Luleve, Marikaj
Contacts: +355 (0) 676022479
donika711@aol.com
Activity: Wine Production & Trade

www.kantinabardha.al

### mozenda

*SHORT BUSINESS PROFILE*
**Mozenda** is an industry leader in web automation and data acquisition. They take unstructured data from the internet and make them useful. They transform web pages into actionable intelligence that provides their customers a competitive advantage so they can know, sell and grow more.

Representative: Mirgen Hoxha
Administrator
Address: Rr. Anton Pashku, Godina 22, Yzberish, Tiranë
Contacts: +355 (0) 675446541
mirgen.hoxha@mozenda.com
Activity: Software Development, Data Scraping from the Web

www.mozenda.com









AmCham Labor and Ethics Committee members who also represent companies in the services and human resources industries held a meeting with Leigh Ann Pagnard, an American human resources expert. Ms. Pagnard is a senior executive and consultant with special expertise on human resources. She has been Technical Staffing Certified (TSC), Certified Staffing Professional (CSP), since 2012 through the American Staffing Association.

## Labor and Ethics Committee

# BRINGS IN U.S. SPECIALIST TO DISCUSS HR DEPARTMENT ISSUES

Committee Chairman Roden Pajaj explained to Ms. Ann Pagnard during the meeting how relationships between employees and employers work in Albania, the general elements of the Labor Code and how HR departments are becoming more and more important for companies. The meeting served to share experiences and Ms. Pagard explained in detail based on her experience the best practices in recruiting and the effective use of HR tools. The meeting served to exchange views on how to address different situations that HR specialists face in their work -- going through not only legal elements but also best practices applied in the United States. Committee members informed Ms. Pagnard about the significant changes Albania's Labor Code has undergone and how they are being implemented. They talked about the most acute problems faced by human resource experts today and the solutions provided through the Labor Code or through courts. The relationship between the employer and the employee and how the Albanian companies have begun to assess human capital and development were also at the center of the discussion during the meeting.




## KOMITETI I PUNËS DHE I ETIKËS

# FLET PËR ZHVILLIMET NË DEPARTAMENTIN E HR-IT ME SPECIALISTEN AMERIKANE

Anëtarë të Komitetit 'Labor & Ethics', të cilët janë edhe përfaqësuesit e kompanive në industrinë e shërbimeve të kapitalit njerëzor, patën një takim me znj. Leigh Ann Pagnard, një profesioniste në industrinë e Shërbimeve të Personelit në SHBA. Leigh Ann është një ekzekutive e lartë dhe konsulente me ekspertizë të veçantë në këtë industri. Ajo ka qenë Personel Teknik i Certifikuar (TSC), *Certified Staffing Professional (CSP)*, që nga viti 2012 nga Shoqata Amerikane e Personelit.

Gjatë takimit, Kryetari i Komitetit z. Roden Pajaj, i shpjegoi znj. Leigh Ann Pagnard se si funksionojnë marrëdhëniet e punës mes punëmarrësve dhe punëdhënësve në Shqipëri, elementë të përgjithshëm të Kodit të Punës dhe mënyrës se si departamentet e HR-it janë duke u bërë gjithnjë e më të rëndësishme për kompanitë. Takimi ka shërbyer si një ndarje experience dhe znj. Pagnard ka shpjeguar me hollësi praktikat dhe eksperiencat e saj në rekrutimin dhe përdorimin efikas të mjeteve të HR-it. Takimi ka shërbyer për të shkëmbyer mendime dhe ide se si mund të zgjidhen situata të ndryshme nëpër të cilat kalojnë specialistët e HR-it, duke ditur jo vetëm hapësirën ligjore, por dhe praktikat më të mira në Amerikë. Znj. Leigh Ann Pagnard është njohur nga anëtarët Komitetit me ndryshimet e rëndësishme që pësoi Kodi i Punës dhe për mënyrën se si janë implementuar ato. Ata folën gjithashtu për problematikat më të mprehta që hasin sot ekspertët e burimeve njerëzore dhe zgjidhjen që ata ofrojnë nëpërmjet Kodit të Punës apo edhe nëpërmjet Gjykatës. Marrëdhëniet mes punëdhënësve dhe punëmarrësve dhe mënyra se si kompanitë shqiptare kanë filluar të vlerësojnë kapitalin njerëzor dhe ta zhvillojnë atë, ka qenë gjithashtu në qendër të diskutimit gjatë takimit.

# Human Resources Training

## for the development of HR functions ranging from Staff to Strategic Business Advisor









The American Chamber of Commerce in Albania organized a Human Resources Training on HR Staff Development, ranging from the roles of HR Staff to Strategic Business Advisor. The training was led by Gordon Paisley, Senior Human Resources Manager at United Airlines in Chicago, United States.

The training took place in two sessions and was devised for high-level HR executives and business leaders working for AmCham Albania members.

In the first session, Mr. Paisley spoke about developing the Human Resources Function - from Staff to Strategic Business Adviser roles. In the second session, he presented the process of drafting a Human Resources and Talent Strategy.

The training was of great interest to the members of the AmCham as they received information on how to turn the Human Resources Department into a strong development tool for their company.

Through techniques and examples, Mr. Paisley, guided participants on how Human Resources turns into a vital function for the company by offering human capital that is responsible for the company's success.

Finding employees and talent development are fundamental to the company's development.

As the company sets its own strategic objectives, affecting the market, its competitors, its development and its profits, HR departments must set objectives in support of the company and its objectives, being flexible and active in filling needs.

To achieve and provide the right HR level of cooperation and support, Paisley spent about five hours in the training, which went over the smallest details that make HR employees successful.




# Trajnimi i Burimeve Njerëzore

## Zhvillimi i funksioneve të Burimeve Njerëzore nga "Personeli" në "Këshilltar Strategjik të Biznesit"

Dhoma Amerikane e Tregtisë organizoi një trajnim të Burimeve Njerëzore me temë "Zhvillimi i Funksionit të HR-it nga "Personeli" në rolin e "Këshilltarit Strategjik të Biznesit", me lektor z. Gordon Paisley, Menaxher i Lartë i Burimeve Njerëzore në United Airlines, në Çikago të SHBA-ve.

Trajnimi u zhvillua në dy seanca dhe u hartua për nivelin e udhëheqjes ekzekutive të biznesit dhe udhëheqësit të funksionit të BNj-ve të anëtarëve të AmCham Albania. Në sesionin e parë, z. Gordon Paisley foli për zhvillimin e funksionit të Burimeve Njerëzore nga "Personeli" në "Këshilltar Strategjik të Biznesit". Në sesionin e dytë, ai paraqiti procesin e hartimit të strategjisë së Burimeve Njerëzore dhe Talenteve.

Trajnimi pati një interes të madh të anëtarëve të Dhomës Amerikane, të cilët morën nëpërmjet tij, informacione të nevojshme se si ta kthejnë departamentin e Burimeve Njerëzore në një mjet të fortë të zhvillimit të kompanive të tyre.

Nëpërmjet teknikave dhe shembujve, z. Paisley, orientoi të gjithë pjesëmarrësit për mënyrën se si të kthejnë Burimet Njerëzore në një funksion jetësor për kompanitë, duke u ofruar kapitalin njerëzor që është përgjegjës për suksesin e kompanisë. Gjetja, punësimi, zhvillimi i personelit dhe i talenteve, janë themelorë në zhvillimin e kompanisë.

Ndërsa kompania vendos objektivat e veta strategjike që prekin tregun, konkurrentët, zhvillimin dhe fitimet, Burimet Njërëzore janë të detyruara të vendosin objektiva në mbështetje të kompanisë dhe të objektivave të saj, duke qenë fleksibël dhe aktivë për atë çfarë ju kërkohet.

Për të arritur këtë nivel të bashkëpunimit dhe të mbështetjes që Burimet Njerëzore duhet të japin, z. Paisley ka shpenzuar rreth pesë orë në një trajnim që orientoi deri në detaje të vogla, detyrat që duhet të ketë një punonjës i Burimeve Njerëzore.




# AmCham Board meets with representatives of **Democratic Party**

The Board of American Chamber of Commerce met with high representatives of Democratic Party in a Working Breakfast to exchange of information on the expectations, issues of AmCham members. The meeting was called by the Economic Development Unit of Democratic Party to include part of the issues in PD's economic program.

Ms. Jorida Tabaku introduced the Democratic Party's Economic Program, the fiscal amenities, sectorial incentives and economic policies that the political force will implement if it will govern.

AmCham President Mr. Enio Jaço highlighted 'the importance of a healthier political-economic climate that foster development and spurs economic growth'. The chamber emphasized a 'rule-based, transparent investment framework, a stronger judicial system to solve business disputes and a bi-partisan need for a unified regional trade agenda' that supports EU accession.

Mr. Enio Jaço also acknowledged the concern from membership, that frequent changes into tax code cause confusion and do not allow the business to make plans. Public procurement is another area where the members feel strongly that the procedures should be improved. The business community has an interest to see a stable political climate because the crises have a negative impact on the economy and business development in the country.

AmCham supports every effort to strengthen the judicial system. Most chambers are interested for the implementation of the justice reform as businesses face uncertainties and disputes that only an independent and efficient judiciary system can solve this cases.




# Dhoma Amerikane takohet me përfaqësues **të Partisë Demokratike**

Bordi i Dhomës Amerikane të Tregtisë u takua me përfaqësues të lartë të Partisë Demokratike në një Mëngjes Pune, për të shkëmbyer informacion mbi pritshmëritë dhe kërkesat e anëtarëve të Dhomës Amerikane. Takimi u thirr nga përfaqësuesit e Partisë Demokratike për të prezantuar programin ekonomik të PD-së.

Znj. Jorida Tabaku prezantoi Programin Ekonomik të Partisë Demokratike, lehtësitë fiskale, nxitjet sektoriale dhe politikat ekonomike që forca politike do të zbatojë nëse do të qeverisë.

Presidenti i AmCham, z. Enio Jaço, theksoi rëndësinë e një klime më të shëndetshme politiko-ekonomike që nxit zhvillimin dhe nxit rritjen ekonomike. Përfaqësuesit e Dhomës gjithashtu theksuan nevojën e kornizës së investimeve transparente, një sistem gjyqësor më të fortë për të zgjidhur mosmarrëveshjet e biznesit dhe një angazhim bi-partizan për një axhendë të unifikuar rajonale të tregtisë që mbështet pranimin në BE.

Z. Jaço ka pranuar si shqetësim që vjen nga anëtarësia e Dhomës ndryshimet e herëpashershme, të cilat shkaktojnë konfuzion dhe nuk e lejojnë biznesin të planifikojë. Prokurimet publike janë një tjetër aspekt që ka tërhequr vëmendjen e Dhomës Amerikane. Komuniteti i biznesit në Dhomën Amerikane ka interes që vendi të ketë një klimë të qëndrueshme politike, sepse krizat sjellin impakt negativ në ekonomi dhe në zhvillimin e biznesit në vend.

Mjaft të interesuar në Dhomën Amerikane janë për zbatimin e reformës në drejtësi, pasi bizneset kanë paqartësi dhe mosmarrëveshje më njëri-tjetrin dhe vetëm një sistem i drejtë dhe efikas gjyqësori mund t'i zgjidhë.






## CSR Project "Green Optimistic"

# Optima Foundation and AmCham together **for a clean coast**

On April 27, AmCham member Optima Legal & Financial organized a volunteer group to clean beaches and forests from litter in Fier's Darezese area, under the Green Optimistic logo, along with young people from McCain Institute in Albania.



Several members of AmCham -- such as the American Bank of Investments, Gener2, Avanntive, Albpastrim -- several youth organizations, international organizations and diplomatic missions accredited in Albania, under the auspices of Fier Municipality and the Ministry of Tourism and Environment participated in this action. About 250 volunteers participated in the activity. The action was followed by a cultural visit to the Apollonia Archaeological Park.

The efforts were an impressive testimony of collective will in support of a just and noble cause. The volunteer action is fueled by the desire for the emancipation of a society that still suffers from the wounds of a somewhat painful past. Like the rallies of flower power in America 40-50 years ago, this action resembles a genuine and peaceful effort for awareness and civic development, as well as a dignified service in protecting our planet or as it was otherwise called by a 4-years-old: "here, where we live."

Cultivating volunteering is a civic need, cooperation with each other for the benefit of the common good is a necessary condition for the creation of a bright-minded and perfect society, as is a precious gift that everyone does to himself and to the prosperity of humanity.

Let's trust that younger generations will rise to the right height to clean up a place that has been usually self-disfigured through time.

Examples of the triumph of good over evil, beauty over ugliness, truth over lies, courage over fear, virtue over vice, freedom over tyranny, and other such examples that are easily found in the activity of the prominent figures of global history and are the source of inspiration for anyone walking the right path.



# Projekti CSR " Green Optimistic"

# Fondacioni Optima dhe Dhoma Amerikane bashkë për një **bregdet të pastër**

Ditën e shtunë, me datë 27 prill 2019, një nga anëtarët e AmCham, Optima Legal & Financial, organizoi një aksion për pastrimin vullnetar të plazhit dhe pyllit në Darëzezë të Fierit, nën logon 'Green Optimistic', së bashku me të rinjtë e Institutit McCain në Shqipëri.

Në këtë aksion, morën pjesë disa anëtarë të AmCham, si Banka Amerikane e Investimeve, Gener 2, Avanntive Consulting, Albpastrim, disa organizata rinore, organizma ndërkombëtare dhe përfaqësi diplomatike të akredituara në Shqipëri, nën kujdesin e Bashkisë Fier dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. Në këtë aksion kontribuan 250 vullnetarë. Ky aksion u pasua nga një vizitë kulturore në parkun e Apollonisë. Ajo që ndodhi, është një dëshmi mbresëlënëse e vullnetit kolektiv në mbështetje të një kauze të drejtë dhe fisnike. Kjo paradë vullnetarizmi ushqehet nga dëshira për emancipimin e një shoqërie që ende vuan nga plagët e një të shkuare paksa të dhimbshme. Ashtu sikurse manifestimet e pushtetit të luleve në Amerikën e para 40-50 viteve, ky aksion ngjan me një përpjekje të çiltër e paqësore për ndërgjegjësim dhe zhvillim qytetar sikundër është edhe një shërbim dinjitoz në mbrojtje të planetit tonë, ose siç e quante ndryshe një fëmijë 4 vjeçar: këtu ku jetojmë neve. Kultivimi i vullnetarizmit është nevojë qytetare, bashkëpunimi me njëri-tjetrin në dobi të së mirës së përbashkët është kusht i domosdoshëm për krijimin e një shoqërie mendjendritur e të përsosur, sikurse është edhe një dhuratë e çmuar që cilido i bën vetes dhe njerëzimit mbarë. Le të besojmë se brezat e rinj do të ngrihen në lartësinë e duhur, për t'i zbardhur faqen këtij vendi të nëpërkëmbur kryesisht prej vetvetes ndër shekuj. Shembujt e triumfit të së mirës mbi të keqen, e të bukurës mbi të shëmtuarën, e të vërtetës mbi gënjeshtrën, e kurajës mbi frikën, e virtytit mbi vesin, e lirisë mbi tiraninë, e të tjerë shembuj të këtillë, që gjenden lehtësisht në veprimtarinë e figurave të shquara të historisë sonë e mbarë botës, janë burim frymëzimi për këdo që ecën në rrugën e drejtë.

# member news

SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA

SIGAL UNIQA Group Austria, the largest insurance company in Albania, on the occasion of the 20th anniversary of its founding, inaugurated a public art sculpture titled "Gratitude - Giving Thanks to All." The purpose and theme of the sculpture, which has been erected near SIGAL UNIQA headquarters in downtown Tirana, was to give thanks to clients, associates and staff for the trust and dedication they have given to the company for 20 years.

The inauguration ceremony was attended by the SIGAL UNIQA Board of Directors, Tirana City Council Chairman Aldrin Dalipi, representatives of ministries and public institutions, ambassadors and other diplomatic representatives, business and financial institutions representatives as well as staff and partners of the company.

Earlier in the headquarters of SIGAL UNIQA, General Director Avni Ponari held a press conference where he expressed his gratitude to the clients, staff and partners of the company.

"The success and the achievements of SIGAL UNIQA Group Austria in these 20 years belong above all to the clients, who have trusted us and continue to trust us, so our celebration of these 20 years is with them and for them," Mr. Ponari said.

During the entire month of March, SIGAL UNIQA turned its headquarters into an open exhibition for the public, where the most renowned Albanian painters exhibited works on the themes of growth, development, vision, gratitude -- the same themes SIGAL UNIQA itself has identified with for 20 years -- and with which its daily work seeks to inspire, to be constantly developing, serving value and not just products.

SIGAL UNIQA has grown over the years, expanding beyond Albania's borders and has become one of the largest insurance groups, with about 1,200 employees serving over 1 million customers in Albania, Kosovo and North Macedonia.

SIGAL UNIQA, since 2002 ranks first in the insurance market in Albania with over 65 million euros in premiums per year and about 300 million euros in damages paid over the years and 121.1 million euros in assets.

Since 2007, SIGAL UNIQA is part of the Austrian insurance giant UNIQA Group Austria, which has a 200-year history in the European insurance market, with the size of 7 billion euros annually and 33 billion euros in assets.

## Albanian Beauty Beli

Satbere Thikaxhija (Beli Kraja Cafi), is the author of seven teaching books being used in all private and state professional institutions.

The methods she writes about have become the go-to literature of beauty technicians and recently they are also available to businesses n Kosovo, enabling an expansion of knowledge beyond the country's borders.

One of the first members of the American Chamber of Commerce in Albania, enrolling in 2000, Albanian Beauty Beli has also helped promote American cosmetic products in Albania and has helped launch many Made in USA products. With her participation at the IBS International Beauty Show, she has made it possible for American cosmetics products to be promoted in Albania as well.

Her professional career started in Rome in 1993-1994, where she studied at the Duilio Due School, after finishing her studies at the University of Tirana Faculty of Economics in 1988, to continue with the opening of the first association of beauty technicians, the National Association Albanian Beauty, in which she serves as President.

BOGA & ASSOCIATES
LEGAL • TAX • ACCOUNTING

**2019 marks Boga & Associates' 25th anniversary**

For the past quarter century, clients have been at the heart of everything we do. Our clients are central to the culture and the way in which we deliver our advice. We support them at all stages of their development, and offer them a full range of legal, tax and accounting services.

Testament to all of the hard work put in by the whole teams at Boga & Associates are the number 1 **rankings for the firm.** Boga & Associates has cemented its place as the leading advisor in Albania with its practices ranked top tier across several major international legal directories including Corporate/Commercial: Chambers Global 2019, Corporate/Commercial: Chambers Europe 2019, Intellectual Property: Chambers Europe 2019, Dispute Resolution: Chambers Europe 2019, Projects: Chambers Europe 2019, Financial/Corporate: International Financial Law Review (IFLR1000) 2019, Project Development: IFLR1000 2019, Dispute Resolution: Benchmark Litigation 2019, Trademarks: World Trademark Review 2019, Media Law: Media Law International 2019.

With its diverse capabilities and experience, the firm acts for leading businesses in most major industries, including banks, financial institutions, companies working in energy, insurance, construction, and utilities, entertainment and media, mining, oil and gas, technology, telecommunications, tourism, transport, infrastructure, consumer goods and international institutions (European Bank for Reconstruction and Development (EBRD), International Finance Corporation (IFC), the World Bank (contributing to "Doing Business").

The firm offers its clients every legal, tax and accounting service, they may need to do business in Albania and Kosovo.

During the quarter century, the firm has advised on privatization transactions, concessions, real estate transactions, setting up businesses, credit facilities, customs, and tax issues, all with a keen sensitivity to developments in the Albanian and Kosovo business environment.

# lajme anëtarësh

SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA

SIGAL UNIQA Group Austria, kompania më e madhe e sigurimeve në Shqipëri, me rastin e 20-vjetorit të themelimit të saj, inauguroi skulpturën: "Mirënjohje - falënderim për të gjithë", realizuar enkas për këtë përvjetor. Qëllimi dhe tematika e skulpturës, e cila u vendos pranë Drejtorisë së Përgjithshme të SIGAL UNIQA, ishte mirënjohja dhe falënderimi për klientët, bashkëpunëtorët dhe stafin për besimin dhe përkushtimin që i kanë dhënë kompanisë për 20 vite.
Në ceremoninë e inaugurimit morën pjesë Bordi drejtues i SIGAL UNIQA, Kryetari i Këshillit Bashkiak të Tiranës, z. Aldrin Dalipi, përfaqësues të ministrive dhe institucioneve publike, ambasadorë dhe përfaqësues të tjerë diplomatikë, përfaqësues të biznesit dhe institucioneve financiare, stafi dhe partnerët e kompanisë. Me herët, në Drejtorinë e Përgjithshme të SIGAL UNIQA, Drejtori i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA, z. Avni Ponari, në një konferencë të mbajtur për mediat shpreu falënderimet për klientët, stafin dhe partnerët e kompanisë.
"Suksesi dhe arritjet e SIGAL UNIQA Group Austria në këto 20 vjet, mbi të gjitha u takojnë klientëve, të cilët na kanë besuar dhe vazhdojnë të na besojnë, prandaj edhe festimet tona në këtë 20 vjetor zhvillohen me ta dhe për ata", -u shpreh z. Avni Ponari, Drejtor i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA Group Austria.
Përgjatë gjithë muajit mars, SIGAL UNIQA i ktheu ambientet e zyrave të saj qendrore në një ekspozitë të hapur për publikun, ku piktorët më të njohur shqiptarë realizuan piktura me tematikë: rritje, zhvillim, vizion, falënderim, pikërisht ashtu siç identifikohet edhe vetë SIGAL-i. SIGAL UNIQA, që prej 20 vitesh, me punën e saj të përditshme kërkon të frymëzojë, të jetë vazhdimisht në zhvillim, të servirë vlera dhe jo vetëm produkte.
Përmasat që SIGAL UNIQA ka marrë përgjatë viteve i kalojnë kufijtë e Shqipërisë dhe është shndërruar në një prej grupeve më të mëdhenj të sigurimeve, ku rreth 1200 punonjës u shërbejnë mbi 1 milionë klientëve në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni. SIGAL UNIQA, që prej vitit 2002 renditet e para në tregun e sigurimeve me mbi 65 milionë euro prime në vit dhe rreth 300 milionë euro dëme të paguara ndër vite, si edhe 121.100.000 Euro ASETE.
Që prej vitit 2007, SIGAL UNIQA është pjesë e gjigandit austriak të sigurimeve UNIQA Group Austria, me një histori 200-vjeçare në tregun europian të sigurimeve, i cili numëron 7 miliardë euro prime në vit dhe zotëron 33 miliardë euro asete.

## Bukuria Shqiptare Beli

Satbere Thikaxhija (Beli Kraja Cafi), është autore e 7 literaturave të mësimdhënies në të gjitha subjektet profesionale private dhe shtetërore. Metodikat e saj janë kthyer në literaturën bazë të estetisteve, dhe së fundmi, janë shpërndarë edhe në bizneset në Kosovë, duke mundësuar kështu zgjerimin e njohurive të saj edhe përtej vendit.
Nga anëtaret e para të Dhomës Amerikane të Tregtisë që prej vitit 2000, Bukuria Shqiptare Beli ka ndihmuar edhe për të promovuar produktet amerikane të kozmetikës në vend dhe ka ndihmuar në lançimin e shumë produkteve 'Made in USA'. Me pjesëmarrjen e saj në Panairin 'IBS International Beauty Show', ajo ka bërë të mundur që produkte të kozmetikës amerikane të promovohen edhe në Shqipëri.
Profesionalizmi i saj i ka fillesat në Romë, në vitet 1993-1994, ku ndoqi studimet në shkollën Duilio Due, në vijim të studimeve në Fakultetin Ekonomik në vitin 1988, për të vazhduar më pas me hapjen e shoqatës së parë të bukurisë 'Shoqata Kombëtare Bukuria Shqiptare', ku është edhe Presidente.

BOGA & ASSOCIATES
LEGAL • TAX • ACCOUNTING

**2019 shenon 25 vjetorin e Boga & Associates.**
Per gjate gjithe cerek shekullit te kaluar, klientet kane zene vendin kryesor ne punen tone, duke i mbeshtetur ne te gjitha fazat e zhvillimit te tyre dhe duke iu ofruar te gjitha sherbimet ligjore, fiskale dhe kontabel te nevojshme per te themeluar dhe ushtruar aktivitetin tregtar.
Tregues i punes se madhe arritur nga avokatet e Boga & Associates, janë renditjet kryesuese per firmen. Boga & Associates ka forcuar akoma me shume vendin e saj si keshilluesi kryesor ligjor ne Shqiperi me praktikat e renditura ne nivelet me te larta ne disa direktori kryesore ligjore dhe financiare nderkombetare duke perfshire: renditjen nr. 1 ne Corporate/Commercial: Chambers Global 2019, Corporate/Commercial: Chambers Europe 2019, Intellectual Property: Chambers Europe 2019, Dispute Resolution: Chambers Europe 2019, Projects: Chambers Europe 2019, Dispute Resolution: Benchmark Litigation 2019, Trademarks: World Trademark Review 2019, Media Law: Media Law International 2019.
International Financial Law Review (IFLR1000) 2019, ka renditur serish Boga & Associates numrin 1 për kategorite e sherbimeve ligjore financiare te zhvillimit te korporatave si dhe ate te projekteve.
Prej cerek shekulli, zyra ofron per klientet e saj te gjitha sherbimet ligjore, fiskale dhe kontabel te nevojshme per te themeluar dhe ushtruar aktivitetin tregtar ne Shqiperi dhe Kosove ne shumicen e industrive kryesore, duke përfshire bankat dhe institucionet financiare, si dhe kompani qe operojne ne sigurime, ndertim, energji, media, miniera, nafte dhe gaz, sherbime profesionale, pasuri te paluajtshme, teknologji telekomunikacioni, turizem, transport, infrastrukture dhe sektore te produkteve te konsumit.
Gjate ketij cerek shekulli, zyra ka ofruar asistence ligjore ne fushen e privatizimit te ndermarrjeve shteterore, koncensioneve, transaksioneve me pasuri te paluajtshme, themelimit te shoqerive tregtare, ne fushen e doganave si dhe ne ate fiskale dhe te kontabilitetit, duke u orientuar vazhdimisht nga nje ndjeshmeri e larte per t'ju pershtatur zhvillimeve ne mjedisin e biznesit shqiptar dhe Kosovar.






# **Albanian CEO** Survey, as part of PwC's 22nd Annual Global **CEO Survey – PricewaterhouseCoopers** *Albania*

PricewaterhouseCoopers (PwC) Albania presented the results of the CEO survey organized with leaders of companies operating in the local market.

More than 50 executives, local and international, from both private and public sector participated at the event held on 17 April 2019.

This is the 22nd year in a row that PricewaterhouseCoopers delivers this survey at an international level, where 1,378 worldwide leaders provide their opinion on economic and operational challenges in short and medium terms, development trends in the market and in their companies. PwC presents the findings of this survey every year in January during the World Economic Forum held in Davos, Switzerland.

In Albania, the CEO survey is organized for the second consecutive year with a considerable participation of well-known companies operating in various sectors like; banking, energy, infrastructure, telecommunication and manufacturing,. CEOs of these companies had the opportunity to share their views on business climate, challenges, economic, political and social environment, talent retain and qualification development in a competitive market oriented towards technology. The Albanian CEO Survey presentation event was opened by Loreta Peci, Country Managing Partner in PwC Albania and Kosovo while the findings and results were presented by Mr. Elvis Ziu, Advisory Leader in PwC Albania and Kosovo. The findings gave the opportunity to all CEOs in Albania to get insights and and compare the results at international/regional and local level.

There was also a panel discussion with CEOs from different sectors; Ms. Linda Shomo, Founder and CEO of EasyPay, Mr. Seyhan Pencabligil, CEO of BKT, Mr. Renis Tershana, Founder and CEO of R&T Group, Mr. Rohan D'Souza, CEO of SHELL Albania, Mr. Eduard Shalsi, Minister of State for the Protection of Entrepreneurship.

In addition to questions and answers, the panel shared their thoughts on economic growth and respective trends, trading



# **Anketimi i CEO-ve** në Shqipëri, si pjesë e Anketimit Global Vjetor të 22-të **PwC - PricewaterhouseCoopers** *Albania*

`PricewaterhouseCoopers (PwC) Albania prezantoi në Shqipëri rezultatet e anketimit të drejtuesve të kompanive që operojnë në Shqipëri.

Në eventin e organizuar në datën 17 prill 2019, morën pjesë më shumë se 50 drejtues të kompanive vendase e ndërkombëtare, përfaqësues të sektorit privat dhe atij publik.

Prej 22 vjetësh PricewaterhouseCoopers zhvillon këtë anketim në nivel ndërkombëtar ku për këtë vit 1,378 drejtues të kompanive ndërkombëtare dhanë opinionin e tyre në lidhje me sfidat ekonomike dhe ato operacionale në nivel afat-shkurtër dhe afat-mesëm si dhe trendet e zhvillimit si në nivel kombëtar ashtu edhe brenda kompanisë apo tregut ku këto kompani operojnë. Këto rezultate prezantohen nga PwC çdo fillim viti gjatë muajit janar në Forumin Ekonomik Botëror të mbajtur në Davos të Zvicrës.

Në Shqipëri, ky anketim u zhvillua për të dytin vit radhazi duke patur një përfshirje të gjerë të drejtuesve të kompanive të mirënjohura nga sektorë të ndryshëm si ai bankar, energjetik, infrastrukturë, telekomunikacion dhe prodhim, të cilët patën mundësinë të ndanin opinionin e tyre mbi klimën, besimin, sfidat e biznesit, mjedisin ekonomik, politik dhe social, sfidat për mbajtjen e talenteve, zhvillimin dhe kualifikimin e tyre në një mjedis konkurrues si dhe përshtatja në një treg gjithnjë e më shumë të orientuar drejt teknologjisë.

Eventi i prezantimit të rezultateve për Shqipërinë u hap nga Znj. Loreta Peçi, Partnere e Vendit për PwC Shqipëri dhe Kosovë ndërsa gjetjet dhe rezultatet u prezantuan nga Z. Elvis Ziu, Advisory Leader për PwC Shqipëri dhe Kosovë. Gjetjet i dhanë CEO-ve në Shqipëri mundësinë për tu njohur dhe krahasuar rezultatet në nivel ndërkombëtar dhe rajonal .

Në prezantim pati dhe një panel të përberë nga drejtues të kompanive nga sektorë të ndryshëm: Znj. Linda Shomo, themeluese dhe CEO në EasyPay, Z. Seyhan Pencabligil, CEO në BKT, Z. Renis Tershana, themelues dhe CEO në R&T Group, Z Rohan D'Souza, CEO në SHELL Albania dhe Z. Eduard Shalsi, Minister Shteti për Mbrojtjen e Sipërmarrjes në Shqipëri.

Përveç pyetje-përgjigjeve, të ftuarit diskutuan mes të tjerash




relations, data usage and security information, shortage of skills and the demand for continuous qualification, alignment of companies with latest technology developments and approach toward Artificial Intelligence.

Based on this year results, there are a number of findings and key messages that should be considered and evaluated from the top management in Albania in order to measure the market trust and expectations on economic development:

Despite the decreasing global trends, Albanian business leaders appear to be more optimistic about both the short term and long-term prospects, where the more optimistic are the CEOs from financial service sector. For 2019, following the same trend as their global peers, Albanian CEOs appear to be more focused on the internal opportunities as key growth drivers, focusing on operational efficiencies, organic growth and launch of new products and services. In a highly competitive market, data monetization exploitation can be described as the fuel driving businesses towards success.

**Artificial Intelligence** is still in its entry stage in Albania, where only 38% of the respondents expects to focus on this area in the next three years.

CEOs of Albanian companies tends to be very much focused in their human resources where shortage of skills and need for continuous training and qualification is a permanent threat together with process automation.

Trading conflicts in growth are one of the main concerns of international leaders, while the goal of local ones remains the consolidation of existing trading relations with traditional partners in the region and not only.

As cyber-attacks have continuously became more frequent, Albanian companies (92% of the respondents) are orienting their efforts and technological developments towards prevention measures. Artificial Intelligence is still in its entry stage in Albania, where only 38% of the respondents expects to focus on this area in the next three years.

In Albania, participated in the survey 66 CEOs, out of which 16 women, sharing their thoughts through completion of the on-line survey or direct meetings and interviews with the team of PwC Albania. In addition to data collection, this survey is a great opportunity for all CEOs to discuss in more details about potential collaboration and services PwC Albania offers in the areas of advisory, tax and audit.







> **Inteligjenca artificiale** mbetet në hapat e saj të parë në Shqipëri, ku vetëm 38% e kompanive vendase parashikojnë ta marrin në konsideratë në 3 vitet e ardhshme.

mbi pritshmëritë në lidhje me rritjen ekonomike, marrëdhëniet tregtare, mbrojtjen dhe përdorimin më së miri te të dhënave apo informacionit që kompanitë disponojnë, përgatitjen e të rinjve për tregun e punës, nevojën për kualifikim të vazhdueshëm të burimeve njerëzore si dhe sfidat e biznesit në shfrytëzimin më së miri të risive në teknologji si dhe qasja ndaj Inteligjencës Artificiale.

Bazuar në rezultatet e këtij anketimi janë një numër gjetjesh apo mesazhesh që duhet të vlerësohen si të rëndësishme për drejtuesit në Shqipëri për të matur besimin në treg dhe pritshmërinë ndaj zhvillimit ekonomik.

Pavarësisht trendit në rënie në nivel global, ka një pritshmëri pozitive midis drejtueseve shqiptarë në lidhje me rritjen ekonomike në 12 muajt e ardhshëm, ku më optimistët shfaqen drejtuesit e bankave apo institucioneve të tjera financiare.

Për vitin 2019, ashtu si drejtuesit ndërkombëtarë edhe drejtuesit në Shqipëri, kanë të njëjtën strategji zhvillimi duke u fokusuar në efiçencën operacionale dhe përmirësimin e procedurave të tyre të brendshme, mundësi e rritjes apo zhvillimit organik si edhe prezantimin e produkteve të reja në treg.

Në një treg gjithnjë e më konkurrues, të dhënat dhe informacioni si dhe përdorimi në maksimum i tyre mund të shihet si një nga katalizatorët e biznesit në rrugën drejt suksesit. Drejtuesit e biznesit në Shqipëri vazhdojnë te jenë shumë të fokusuar në burimet e tyre njerëzore duke parë si shqetësim kryesor jo vetëm automatizimin e proceseve por dhe mungesën e kualifikimit dhe nevojës së vazhdueshme për t'u trajnuar apo zhvilluar profesionalisht.

Konfliktet tregtare në rritje gjatë viteve të fundit janë një nga shqetësimet kryesore të drejtuesve ndërkombëtarë ndërkohë që pritshmëritë e drejtuesve në Shqipëri vazhdojnë të mbeten konsolidimi i marrëdhënieve me partnerët tradicionalë në rajon dhe jo vetëm. Me sulmet kibernetike gjithnjë e më shumë në rritje, kompanitë në Shqipëri (92% e përgjigjeve) po i orientojnë përpjekjet dhe zhvillimet e tyre teknologjike gjithnjë e më shumë ndaj masave mbrojtëse kundrejt këtyre sulmeve.

Inteligjenca artificiale mbetet në hapat e saj të parë në Shqipëri, ku vetëm 38% e kompanive vendase parashikojnë ta marrin në konsideratë në 3 vitet e ardhshme.

Për Shqipërinë në anketim morën pjesë 66 drejtues, 16 nga të cilët femra, duke dhënë opinionin e tyre nëpërmjet plotësimit te pyetësorit on-line si dhe nëpërmjet takimeve e intervistave të drejtpërdrejta me stafin e PwC Albania. Krahas mbledhjes së të dhënave, ky anketim është një mundësi shumë e mirë për CEO-t për të diskutuar më konkretisht mbi mundësitë e bashkëpunimit dhe shërbimet e ofruara nga PwC Albania në fushën e konsulencës financiare, fiskale dhe auditimit financiar.



# FORMALIZING

## the economy through cashless bank transactions

**AVNI PONARI**
CEO of Sigal Uniqa Group Austria

**The formalization of the economy starts with using banks for transactions.** That's the key to any formalized economy. How and in what amount that is accomplished indicate the level of formalization achieved. *But how well prepared is Albania for the use of these transactions?*

It's an analysis that requires a lot of exploration, but, in my view, a lot of work remains to be done. And if we move in that direction, the first question would be: What does Albania's banking system offer? Today, more than 90 percent of Albanians use only cash in their transactions, skipping the banks.

**According to a Bank of Albania study, Albanians use cash in more than 90 percent of transactions involving consumer goods and utility services like bill payments and other obligations. More than 70 percent of payments to hotels and travel agencies are also done in cash.**

**The reason behind this prevalent use of cash is that Albanians believe cash payments are more practical and have no extra costs. But, but on the other hand, they also express a kind of mistrust and lack of knowledge of cashless transactions.**

The main and most widespread argument for not using other payment instruments is the fact that many consumers link cashless transactions to additional costs, so non-cash payments made through the banking system are considered more costly.

Consequently, citizens choose the least costly way to make payments for the services they need -- which is paying in cash. This is at a time when some of the world's most advanced and largest economies are transforming into cashless economies. These include places as varied as Sweden, which is becoming one of the world's most cashless countries, and China, where tech companies like Baidu and Alibaba are seriously threatening the foundations of the cash payment system through banks.

In the case of Albania, the pace of development toward a cashless economy remains low, and the country's economy is currently located between the Third and Fourth Industrial Revolutions. Currently, Albania faces a very low level of financial culture, where the use of cash is deeply rooted among citizens and getting rid of that way of thinking is going to require a large amounts of effort. According to Bank of Albania data, the market now has 940,000 bank cards in circulation -- in other words, 41 percent of the employed population has a bank card. This is one side of the coin, but it's important to look at the other side. About 91 percent of that number is made up of debit cards tied to the checking/current accounts of individuals and are used mostly to withdraw cash from ATMs. Of the more than 200 billion leks of card transactions per year, more than 92 percent are cash withdrawals. Visit any ATM terminal (the few that are available) at the end of the month, and you will see a line of people waiting to with-

# FORMALIZIMI

## i ekonomisë përmes pagesave nëpërmjet bankës



**Formalizimi i ekonomisë fillon përmes transaksioneve bankare.** Ky është çelësi i çdo ekonomie të formalizuar. Sa dhe si bëhet kjo, tregon edhe nivelin e formalizimit të saj. *Por, sa dhe si është përgatitur Shqipëria për të kryer këto transaksione?*

**AVNI PONARI**
CEO Sigal Uniqa Group Austria

Kjo analizë kërkon shumë punë, por e parë nga këndvështrimi im mendoj se ka shumë për të bërë. Dhe nëse i drejtohemi këtij lloj shërbimi, pyetja e parë është: Çfarë lehtësirash ka sistemi bankar në Shqipëri? Sot, mbi 90 për qind e shqiptarëve paguajnë vetëm *cash* dhe jo me banka.

**Sipas një studimi të Bankës së Shqipërisë, rezulton se përdorimi i parave cash nga shqiptarët është në masën mbi 90 për qind në dyqanet e mallrave të konsumit dhe shërbimet utilitare si pagesat e faturave dhe detyrimeve, dhe në masën mbi 70 për qind për pagesat në hotele dhe agjenci udhëtimi.**

**Arsyet e përdorimit kaq shumë të parasë *cash* lidhen me faktin se qytetarët shqiptarë mendojnë se pagesa cash është më praktike dhe nuk ka shpenzime ekstra, por nga ana tjetër shpreh një lloj mosbesimi dhe njohje ndaj transaksioneve të tjera përveç cash-it.** Argumenti më kryesor dhe më i përhapur në popullsi për mospërdorimin e instrumenteve të tjera të pagesave është fakti se shumë konsumatorë e lidhin përdorimin e tyre me kosto shtesë, pra, pagesat jo-*cash* që kryhen nëpërmjet sistemit bankar konsiderohen si më të kushtueshme.

Për rrjedhojë, qytetarët zgjedhin mënyrën më pak të kushtueshme për të kryer pagesat për shërbimet që atyre u nevojiten dhe që është pagesa me para në dorë. Disa ekonomi të përparuara dhe të mëdha në botë po shkojnë drejt ekonomive jo-*cash*, siç është Suedia, që po bëhet një nga shoqëritë më jo-*cash* në botë dhe Kina, ku kompanitë "Baidu" dhe "Alibaba" po kërcënojnë seriozisht themelet e sistemit të pagesave *cash* nëpërmjet bankave në Kinë.

Në rastin e Shqipërisë, ritmi i zhvillimit drejt ekonomisë jo-*cash* mbetet i ulët dhe ekonomia gjendet aktualisht midis Revolucionit të Tretë dhe të Katërt Industrial. Aktualisht, Shqipëria ballafaqohet me një nivel shumë të ulët të kulturës financiare, ku përdorimi i parasë *cash* te qytetarët është i ngulitur thellë dhe duhet punuar shumë që të çrrënjoset ky mentalitet i vjetër. Sipas të dhënave nga Banka e Shqipërisë, numri i kartave bankare ka shënuar nivelin 940 mijë ose e thënë ndryshe 41 për qind e popullsisë së punësuar shqiptare zotëron një kartë bankare. Kjo është njëra anë e medaljes, por cila është ana tjetër? Faktet tregojnë se 91 për qind e këtyre kartave janë karta debiti (që lidhen me llogaritë rrjedhëse të individëve) dhe përdoren vetëm për të tërhequr para *cash* (rrogën) nga bankomati. Nga mbi 200 miliardë lekë veprime me karta në vit, mbi 92 për qind janë tërheqje *cash*. Po të shohim çdo fundmuaj, terminalet ATM të bankave (ato pak që janë) janë të populluara nga qytetarë që presin të tërheqin rrogën e tyre. Ndërkohë që në vende të zhvilluara, kartat janë pjesë e jetës së përditshme dhe përdorimi i tyre është i konsoliduar, në ekonomi të reja në zhvillim si kjo e jona, përdorimi i tyre është në nivele primitive, nëse do ta quajmë kështu. Shqipëria është i vetmi vend në rajon, i cili ka numrin më të vogël të POS, ATM-ve, *e-banking*, kartave të kreditit dhe kartave të

draw their salary. While in developed countries bank cards are part of everyday life and their use is consolidated, in emerging and developing economies like ours, their use is at primitive levels, if we can call it that. Albania is the only country in the region which ranks at the bottom of the list in terms of having the lowest number of electronic Points of Sale (POS), ATMs as well e-banking, credit card and debit card transactions. Consequently, it also has the lowest number of bank transactions. But what factors influence the use of cash rather than bank transactions? Why do Albanians use cash almost exclusively in shops, cafes, restaurants, roads and hospitals as well as in utility, tax and insurance payments -- or any other service for that matter?

The use of excessive banking fees for bank transfers (2 to 3 percent) is one of the main motives for Albanians to use cash rather than bank transfers. The POS commission fee is very high at 1.8 to 3.5 percent, which again does not favor the use of bank transfers. There also high commissions for cash withdrawals at ATMs. Some of the banks in Albania also charge bank fees for salaries, a commission that for small wages affects the pocket of citizens and makes it better to use cash rather than a POS. In addition to high fees that the banks charge transactions carried out by individuals or businesses, currency conversion is another factor. This is due to the fact that when a payment is made in banks in Albanian leks (ALL), often it is automatically converted to euro without first receiving the approval of the interested party. What an Albanian wonder! So, the service offered by banks when it comes to cashless transactions is not very efficient. Many banks, which offer card payments for online purchases, plane tickets or holiday bookings, require a card user's approval, through a personal phone. But this becomes dysfunctional in cases when the person is at airport terminals, during flight or in locations where the phone has to be switched off. In such cases, the banking transaction cannot go through and the bank blocks the card.

**The use of excessive banking fees** for bank transfers (2 to 3 percent) is one of the main motives for Albanians to use cash rather than bank transfers.

## **BUT WHAT CAN BE DONE** TO A MOVE TO A CASHLESS ECONOMY?

